

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7711 E premte 16 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Është fjala për demarshet mbi krijimin e ushtrisë së bashkët evropiane, që u propozua në fillim të muajit nga Presidenti francez, Macron ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Garanci për
sigurinë europiane



Dje

në "Deutsche Welle"

Lajmi i mirë në fillim: Pas vitesh të gjata oponente për ardhjen e migrantëve dhe refuzimit për pranimin e refugjatëve, Viktor Orban më në fund u dorëzua ...
Vijon në faqen 21

Nga BORIS GEORGIEVSKI

Viktor Orban më në fund
e hapi derën për një refugjat



Dokumentet që mungojnë në çdo dosje
**Ish-të përndjekurit,
5700 emrat që do
kompensohen, kush
janë trashëgimtarët**

Lista e gjashtë/ Dëmshtëpërlimi financiar.
3 muaj afat për plotësimin e dokumenteve

Rreth 5700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin kështu e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dje nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfuttes të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshtëpërlim ...
Në faqet 11-13

MISTERI/ ISH-KRYEMINISTRI I MAQEDONISE UDHETOI ME MAKINE DIPLOMATIKE

GRUEVSKI ARRATISSET PERMES SHQIPERISE

I dënuari me burg për shpërdorim detyre kërkoi azil në Hungari. Doli nga Hani i Hotit, mister pika hyrëse. SHBA: Të vuajë dënimin në Shkup. Reagon Meta: Pranoi fajësinë



(Në foto) Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski gjatë një qëndrimi në Tiranë në vitin 2015

PRESIDENTI

**Dekreti i Lleshit?
Meta: Nuk më bën
presion askush, do
zbatoj Kushtetutën**

Në faqen 5

FAMILJA: S'KEMI KONFLIKTE

**Vrasja e tregtarit,
këshilltari bashkiak
në polici: Nuk kam
lidhje me ngjarjen**

Në faqen 7

OPOZITA

**PD-LSI, konsulta për
bashkitë. Kryemadhi:
Ndërkombëtarët,
ndonjëherë naivë**

Në faqen 4

UDHEZIMI

**Ambasada e SHBA:
Studimet, nuk mund
të punoni për të
paguar shkollën**

Në faqen 8

PROTESTA PER UNAZEN E RE



**Banorët: I mbrojmë
shtëpitë me gjak.
Veliaj: U goditën
policiët bashkiakë**

Në faqet 2-3

Vendimi i Gjykatës së Apelit: Arben Çuko dhe Arben Ndoka lihen në arrest shtëpie

"Shfryhet" operacioni, lirohen 2 ish-deputetët e PS

Shkarkohet prokurori që firmosi arrestin e Fullanit dhe Shpëtim Gjijkës

TIRANË- Dy ish-deputetët socialist, Arben Ndoka dhe Arben Çuko janë liruar nga gjykata afro një muaj pas arrestimit të tyre në kuadër të operacionit të koduar "VOL-VO 4". Tre-shja gjykoese e Apelit për Krime të Rënda e kryesuar nga gjykatësi Sokol Binaj, ua hoqi pran-



gat nga duart ish-deputetëve në fjalë, pasi vendosi ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest shtëpie". Ndërsa ka lënë në burg të "fortët" e Shijakut, grupin e Avdyllajve, të akuzuar për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal. Ish-drejtori i Përgjithshëm ...
Në faqen 6

UNAZA E MADHE PROTESTA

Kapsollë, vezë dhe tymuese, banorët e 'Astir' tentuan hapjen me forcë të dyerve të bashkisë

Protestuesit mesazh Ramës dhe Veliajt: Presidenti është me ne

"Tërhiquni, banesat do i mbrojmë me gjak!"

Valentina Madani

Protesta e djeshme e banorëve të zonës së "Astir" që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe u shoqërua me incidente dhe përplasje të forta mes Policisë Bashkiake dhe protestuesve. Banorët e Unazës së Re hodhën kapsollë, tymuese dhe vezë para godinës së bashkisë duke kërkuar për më shumë se 1 orë, dëmshtëpëllim të plotë për pronat e tyre që preken nga zgjerimi i rrugës. Ata i bënë thirrje kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliajt, të marrë vendim në këshillin bashkiak për t'i dëmshtëpëllim 100% për banesat e tyre. Protesta para bashkisë u zhvillua paralel me mbledhjen e këshillit bashkiak në të cilën nuk ishte i pranishëm kryetari Erion Veliajt, i cili mësohet se ndodhet jashtë shtetit. Protestuesit, kërkuar reagimin e bashkisë dhe qeverisë, ndërsa theksuan se në çdo rast do t'i mbrojnë me gjak pronat e tyre. Me thirrje dhe me pankarta në duar, banorët e zonës së Astirit qëndruan para godinës duke i kërkuar llogari kreut të bashkisë për votën dhe për pretimet, që ky i fundit iu kishte dhënë. "Jemi qytetarë, t'i je shpellarë dhe duam shtëpitë tona", ishin disa nga thirrjet e protestuesve. Në mbështetje të protestuesve ishin deputetët dhe anëtarët e PD-së dhe të LSI-së në këshillin bashkiak të Tiranës. Një nga protestuesit është ndër keq ndërkohë që në protestë kishte edhe gra dhe fëmijë. Përgjatë një ore pati tensione mes banorëve dhe policisë. Me tymit të flakadaneve, banorët shtynin policët për të depërtuar tek dera e bashkisë, e cila ishte e mbyllur dhe e rrethuar nga kordonë policësh. Pranë saj u ndez një zjarr i vogël te dera, ndërkohë që protestuesit deklaruan se "Shtëpitë do i mbrojmë me gjak". "Duam shtëpitë tona, duam pronat tona" - ishte thirrja e përsëritur nga radhët e protestuesve. Njëri nga protestuesit deklaroi: "Ju bëjmë thirrje me lozni me gjakun tonë. Banojmë në Un-



PLAGOSJA

Në drejtim të efektivëve të policisë bashkiake, të cilët kishin krijuar kordonin e sigurisë u hodhën kapsolla te dera e bashkisë, duke lënduar 7 punonjës të Policisë Bashkiake, të cilët janë transportuar në spital për ndihmën e parë mjekësore. Efektivët kanë pësuar djegie nga shashkat.



Protesta e djeshme para bashkisë

VIZITA

Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Andi Seferi vizitoi dje punonjësit e Policisë Bashkiake në pavionin e Spitalit të Traumës, të cilët mbeten të plagosur në protestën e sotme të banorëve të Unazës së Re të mbështetur nga opozita. Pasi u njoh me gjendjen shëndetësore të punonjësve të Policisë Bashkiake, nënkryetari Seferi tha se dëmtimet e tyre janë serioze dhe një pjesë e tyre kanë marrë edhe plagë djegie.

Ndërtimi i Unazës, Gjijnuri: 3 vite qira dhe përparësi banesat sociale

Një ditë pas deklaratës së Presidencës lidhur me protestën e banorëve të zonës së Astirit, të cilët kundërshtojnë prishjen e ndërtimeve që preken nga ndërtimi i Unazës së Re, ka reaguar ministri i Infrastrukturës Damian Gjijnuri. Përmes një statusi në rrjetet sociale Gjijnuri bën të ditur se segmenti i përfunduar urban i Unazës së Madhe nga Komuna e Parisit tek Shkolla Teknologjike është modeli i qeverisë për Tiranën e së ardhmes. Ndërkohë që theksoi edhe një herë zgjidhjen që i është ofruar banorëve të Unazës së Madhe, ku veç shpronësimit të atyre që i kanë pronat e ligjshme, qeveria do ofrojë bonus qira për 3 vite për ata që nuk i kanë të legalizuara. "Për çdo skeptik, ky është standardi



me të cilin do ndërtohet dhe segmenti nga Shkolla Teknologjike tek sheshi 'Shqiponja'. Pronarët shpronësohen 100%, ata pa leje do marrin 3 vite qira, dhe do trajtohen me përparësi për banesat sociale" - shkruan Gjijnuri në Facebook. Por pika e shpronësimeve është edhe debati që ka revoltuar banorët duke i ngritur ata në pro-

testë. Ndërsa qeveria është e vendosur për shpronësim 100% për banorët me pronësi të rregullt të tokës dhe banesave, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, që nuk përfshin vlerën e tregut, banorët thonë se nuk janë kundër projektit, por kërkojnë shpronësimin e banesave të tyre 100% sipas vlerës së tregut.

në Tiranë mes qytetarëve dhe autoriteteve për shkak të ndërtimit të Unazës së Re". Presidenti Meta bëri thirrje për vendosjen e një dialogu dhe konsultimi mes qytetarëve dhe autoriteteve, me qëllim që të gjithë ankesat të vlerësohen me transparencë dhe përçojësi, me qëllim ar-

PROJEKTI

Akuzat e PD, ARRSH: Projekti për Unazën në përputhje me ligjin

Autoriteti Rrugor Shqiptar reagoi një ditë pas akuzave të bëra nga kreu i PD, Lulzim Basha në lidhje me projektin për ndërtimin e Unazës së Re. Në një deklaratë për mediat, ARRSH hedh poshtë deklaratat e kreut të PD, duke thënë se projekti është në përputhje të plotë me ligjin dhe se është vazhdim i projektit të Bashës. "Autoriteti Rrugor Shqiptar, si organ më i specializuar dhe që ka financuar e menaxhuar projektet dhe ndërtimet e segmenteve të tjera të kësaj Unaze, është vënë në lëvizje për këtë projekt nga kërkesa e Bashkisë së Tiranës me shkresën nr. 3792 prot dt. 25.01.2018. Kështu, ARRSH-ja sot (apo ish-DPRR-ja) ka ndjekur të njëjtën praktikë siç u ndoq në kohën kur Bashkinë e Tiranës e drejtojnë kryetari aktual i Partisë Demokratike z. Lulzim Basha", thuhet në reagimin e ARRSH. ARRSH shton se këtij projekt i është shtuar edhe projekt zbatimi i hartuar e i miratuar po nga Bashkia Tiranë në vitin 2013, "Sistemi i lumit të Lanës dhe rrugët paralele në të dyja anët, nga ura e shkollës deri te materniteti i ri i Tiranës, me një gjatësi rreth 1.6 km, ku seksioni tërthor i saj është po i kategorisë A urbane. Nga ky projekt ka mbartur së ndërtuari loti 1 dhe po ndërtohen lotet 2 dhe 3, dhe segmenti nga Materniteti i ri - Shkozë. Janë pa u ndërtuar akoma edhe tre lote nga Ura e Shkozës deri në Babrru (lumi i Tiranës).

ritjen e një zgjidhjeje të drejtë dhe objektive. Gjatë protestës së djeshme, në drejtim të efektivëve të Policisë Bashkiake, të cilët kishin krijuar kordonin e sigurisë u hodhën kapsolla te dera e bashkisë, duke lënduar 7 punonjës të Policisë Bashkiake, të cilët janë transportuar në spital

për ndihmën e parë mjekësore. Efektivët kanë pësuar djegie nga shashkat. Pas më shumë se 60 minuta me parullat, të cilët kishin krijuar kordonin e sigurisë u hodhën kapsolla te dera e bashkisë, duke lënduar 7 punonjës të Policisë Bashkiake, të cilët janë transportuar në spital



Valentina Madani

Protesta e banorëve që preken nga Unaza e Madhe ka krijuar një përplasje tjetër mes mazhorancës qeverisëse dhe opozitës. Mazhoranca përmes kreut të bashkisë, Erion Veliaj, këmbëngul se rruga do të bëhet ndërkohë që opozita insiston që më parë të dëmshpërblehet çdo banor i prekur nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Edhe protesta e djeshme e banorëve tek "Astiri" para dyerve të bashkisë u bë shkak për akuza dhe kundëruakuza mes palëve. Pas lëndimeve të disa punonjësve të policisë në protestën e djeshme, i menjëhershëm ishte reagimi i kreut të bashkisë, Erion Veliaj. Përmes një postimi në "Facebook", ai deklaroi se qyteti i Tiranës do të triumfojë përballë barbarisë. Duke i uruar shërim të shpejtë policëve të lënduar, kreu i bashkisë thekson faktin se puna do të prevalojë përballë dhunës dhe se projekti nuk ka ndërmend të ndalet. "Mirënjohje të thellë policëve bashkiakë për qytetarinë e treguar përballë partisë së dhunës, hurit e zjarrit! Shërim të shpejtë oficerëve të plagosur! Si tek Lodrat, Sheshi 'Skënderbej' dhe Pazarri i Ri, puna do e mundë dhunën dhe qyteti do triumfojë mbi barbarinë! Ta harrojnë, Tirana nuk ndalet më!", shkruan Veliaj. Kujtojmë se banorët e zonës së "Astirit" janë në ditën e 13 të protestës, ndërsa kanë njoftuar se rezistenca e tyre përballë dhunës së "pushetit" do të vijojë deri në marrjen e dëmshpërblimeve sipas parashikimeve ligjore. Projekti i Unazës së Re do të prekë më shumë se 300 objekte, mes tyre shtëpi banimi dhe biznese.

ERION VELIAJ

"Mirënjohje të thellë policëve bashkiakë për qytetarinë e treguar përballë partisë së dhunës, hurit e zjarrit! Shërim të shpejtë oficerëve të plagosur! Si tek Lodrat, sheshi 'Skënderbej' dhe Pazarri i Ri, puna do e mundë dhunën dhe qyteti do triumfojë mbi barbarinë! Ta harrojnë, Tirana nuk ndalet më!", shprehet z.Veliaj.



JOZEFINA TOPALLI

Ish-nënkryetarja e PD-së akuzon kreun e opozitës, Lulzim Basha, se i ka lënë në baltë banorët e "Astirit", që preken nga Unaza e Madhe, ashtu siç ia në baltë kuskianët. "Sa për adet i çon 2-3 të emëruar të tij, që askush nuk i logarit dhe si Pilati lan duart".



"Deputetët goditën policët". Opozita, kreut të bashkisë: Vërteto akuzat, ose lër mandatin

Veliaj: Triumf mbi barbarinë. PD: Kërko falje për "shpellarët"

"Fyerje raciste e përçarëse ndaj banorëve"



Kreu i bashkisë, Erion Veliaj

ÇOLLAKU

"Nuk kemi asnjë informacion për shtyrjen, por ne jemi një vendim të përbashkët, në mbështetje të kësaj proteste. Por sidomos për shkak të aktit dhe sjelljes së paprecedente që Veliaj fyeu qytetarët. Ne kemi një vendim të përbashkët për të bojkotuar mbledhjen. Fjala e tij është një lëpirje e asaj që tha. Më dinjitoze është që ai të kërkojë falje".

"Opozita, betejë idioteske për të penguar rrugën"

Balla: Gjurma e Unazës me firmë të Bashës, të sqarojë banorët

Nga salla plenare e parlamentit, mazhoranca akuzoi dje opozitën se po pengon ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës, duke krijuar betejë që shumica e majtë i quan idioteske. Kreu i grupit të PS, Taulant Balla tha nga foltorja e Kuvendit se projekti i Unazës së Re do të vazhdojë, pavarësisht protestës së banorëve. Kreu i deputetëve socialistë kërkoi që Lulzim Basha të sqarojë banorët e "Astirit" për projektin e zgjerimit të Unazës së Madhe, i cili prek disa banesa dhe biznese. Sipas Ballës, Basha është njeriu që ka firmosur gjurmën e Unazës si ish-ministër i Transporteve dhe ish-kryetar i Bashkisë së Tiranës. Ai akuzoi opozitën se po bën çmos që të pengojë realizimin e këtij projekti, duke e quajtur përpjekjen e PD-së një betejë idioteske. Balla shtoi gjithashtu se Basha ka qenë pjesë e realizimit të projektit për zgjerimin e Unazës, ndryshe nga sa pretendon tani. Sipas tij, është e turpshme që PD dhe LSI dalin kundër sa herë ka një projekt zh-



Kreu i Grupit të PS, Taulant Balla

villimor. "Pas dështimit me parkun te liqeni, pas dështimit me sheshin 'Skënderbej', pas historisë së kotë me teatrin, tani kemi betejën idioteske për të penguar ndërtimin e unazës", dek-

laroi Taulant Balla. Ai u sugjeroi protestuesve që t'i kërkojnë shpjegime kreut të opozitës, pasi sipas Taulant Ballës, është vetë Lulzim Basha, ai që ka firmosur gjurmën e zgjerimit të Un-

DEKLARATA

"Pas dështimit me parkun te liqeni, pas dështimit me sheshin 'Skënderbej', pas historisë së kotë me teatrin, tani kemi betejën idioteske për të penguar ndërtimin e unazës", tha z.Balla.

tuar shtëpinë. Njerëz që pavarësisht se u cenohet jeta e tyre, ata protestojnë në mënyrë të qytetare. Protesta do vazhdojë edhe brenda bashkisë. Sot (dje) këshilli bashkiak është këtu nuk është brenda mureve të bashkisë", tha Çollaku. Kurse deputeti i PD, Klevis Balliu sfidoi kryetarin e bashkisë Erion Veliaj pas

deputetët e opozitës janë përplasur me Policinë bashkiake. Nëse kjo është e vërtetë unë jap dorëheqjen nga mandati i deputetit. Por nëse s'është e vërtetë, dorëheqjen duhet ta japësh ti, Erioni i Griseldës. Do u lutesha qytetarëve të hapin zemrat e tyre dhe të mendojnë për një minutë se pse po luftojnë këta banorë. A

kanë të drejtë apo jo? Nëse do mendohen pak, do të kuptojnë se këta banorë që kërkojnë kompensimin e tyre, pasi kanë 20 vite që paguajnë taksa, pasi janë në proces legalizimi dhe kanë paguar paratë tek ALUIZNI. Sot të gjithë këta banorë kanë të drejtën e kompensimit", shprehet deputeti i PD-së.

ZGJEDHJET OPOZITA

Kryemadhi ka deklaruar se LSI po bisedon me PD për të zgjedhur emrat më të mirë

PD dhe LSI nisin diskutimet për kandidatët për kryetar bashkie

"Nuk jam e bindur që do këtë vetëm zgjedhje vendore në qershor"

Pavarësisht se prej disa muajsh ka bojkotuar jetën parlamentare dhe reformën, opozita po bëhet gati për zgjedhjet e ardhshme vendore. Paralelisht me betejën e saj politike për denoncimin e çdo lloji afere korruptive apo edhe kriminale të qeverisë, partitë opozitare kanë nisur përgatitjet për të qenë gati për zgjedhjet e ardhshme për pushtetin vendor, që pritet të mbahen në 30 qershor. Nga Dibra, ku morri pjesë në një takim me strukturat drejtuese lokale të LSI-së, Monika Kryemadhi ka bërë të ditur ndër të tjera kanë nisur bisedimet me Partinë Demokratike dhe partitë e tjera të opozitës për të zgjedhur kandidatët për kryetar bashkie dhe kandidatët për këshilltarë bashkiakë. "Data e zgjedhjeve lokale është dekretuar dhe ne duhet të jemi të gatshëm për të përgatitur listën e këshilltarëve. Po përgatitemi dhe po konsultohemi edhe me partitë e opozitës për të zgjedhur kandidatët për kryebashkiakë. Strukturat tona të LSI duhet të fillojë rakordimin me PD dhe partitë e tjera të opozitës për listat e këshilltarëve", tha Kryemadhi, e cila konfirmoi në këtë mënyrë se pavarësisht bojkotit aktual të institucionit ligjvënës, opozita do të marrë pjesë në zgjedhje. Gjithsesi, ajo la të kuptohet se për shkak të situatës politike dhe qeverisë, nuk përjashtohet mundësia që në qershor të zhvillohen bashkë zgjedhjet vendore dhe ato të parakohshme parlamentare. "Unë nuk jam e bindur që do këtë vetëm zgjedhje vendore në qershor, për shkak të situatës politike. Vendi është pushtuar nga kaosi dhe pasiguria. Ju keni parë se si Vangjush Dako komunikonte me bandat për të tjetërsuar votën. Do këtë fakte me zë dhe figurë se si tjetërsohet vota", - tha Kryemadhi.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

Pollo: Deklarata e BE konfirmoi se Shqipëria nuk ka bërë progres

Bashkëkryetari i Komisionit të Integritimit, Genc Pollo, duke iu referuar rezultateve të takimit të Këshillit të Stabilizim-Asocimit Shqipëri-BE dhe deklaratave të bëra nga Frederica Mogherini, thekson se mesazhi ishte i qartë se me qeverinë aktuale, lufta ndaj krimit është një pengesë dhe për rrjedhojë kjo ndikon edhe për Integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Sipas tij, Shqipëria nuk është vlerësuar, por përkundrazi, Mogherini siç shprehet ai, listoi disa problematika ku korrupsioni mbetet ende problem në disa sektorë të qeverisjes së kësaj mazhorance. "Ndërkohë që në mbledhjen para një viti, më 15 nëntor 2017, znj. Mogherini mirëpriti hapat kundër krimit e korrupsionit e suksese kundër kanabisit", në vijim të mbledhjes së djeshme u tha se "BE ritheksoi nevojën kritike për të arritur rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimit të organizuar", tha Pollo.

MANDATET

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, e pyetur për kthimin e deputetëve të opozitës në Kuvend është shprehur se Shqipëria ka probleme shumë më të mëdha. Dhe mendoj që mandatet e deputetëve sot përballë këtyre realitetit shumë të hidhur nuk janë asgjë", u shpreh ajo.

PD: Pa arrestuar

Dakon, s'mund të ketë zgjedhje të lira

Partia Demokratike kërkoi edhe dje arrestimin e kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako. Deputeti demokrat, Endri Hasa, në një dalje prej mediatë e tha se heshtja prej ditësh edhe me censurë mediatike nuk mbulon krimin elektoral të Vangjush Dakos. Hasa theksoi se kryetari i Bashkisë së Durrësit duhet të ndëshkohet me burg për bashkëpunimin me organizatën kriminale të bandës së Avdyllajve, për blerjen e votave në shërbim të qeverisë. "Faktet e krimit elektoral të Vangjush Dakos janë të qarta dhe për këtë krim, ai duhet të jetë në burg! Heshtja e prokurorisë prej më shumë se 3 javësh, pa bërë përpjekjen më të vogël për hetim, konfirmim kapjen e drejtësisë nga Edi Rama. Pa arrestimin e Dakos, s'mund të flitet as për kthimin e besimit të publikut të drejtësisë dhe as të shprehohet se në vend mund të ketë zgjedhje të lira e demokratike", tha Hasa.

më duket problemi kryesor sot është qarta dhe mandatet e deputetëve, sepse Shqipëria dhe politika shqiptare kanë probleme shumë më të mëdha. Dhe mendoj që mandatet e deputetëve sot përballë këtyre realitetit shumë të hidhur nuk janë asgjë", u shpreh ajo.

KANDIDATËT

"Data e zgjedhjeve lokale është dekretuar dhe ne duhet të jemi të gatshëm për të përgatitur listën e këshilltarëve. Po përgatitemi dhe po konsultohemi edhe me partitë e opozitës për të zgjedhur kandidatët për kryebashkiakë. Strukturat tona të LSI duhet të fillojë rakordimin me PD dhe partitë e tjera të opozitës për listat e këshilltarëve".



Presidenti Ilir Meta dje në konferencën ndërkombëtare të gazetarëve të Europës Juglindore "South East Europe Medi Forum"

"S'ndodh në asnjë vend që opozita të mos diskutojë për buxhetin"

PS, opozitës: Lëri takimet në hotele, kthehuni në Kuvend

Nga foltorja e Kuvendit, ku sërisht partitë parlamentare të opozitës munguan, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla u kërkoi atyre që të rikthehen në Kuvend, pasi javën tjetër diskutohet buxheti i vitit 2019. Sipas tij, është e pafalshme për një opozitë që mungon gjatë debatit për buxhetin, ku jo vetëm mund të vërehet në pah problemet e tij, por edhe mund të kontribuojë për ta përmirësuar atë. "Sot nuk kanë ndonjë takim në hotele ata, se e kanë pushim, sikurse e kanë marrë pushim prej javësh. Detyra jonë është që të miratojmë këto marrëveshje. Javën e ardhme diskutohet në parim buxheti i shtetit dhe paketa fiskale për 2019-en."



Apeli im si kreu i grupit parlamentar të shumicës në Kuvend është që të enjten e ardhshme opozita e ka për detyrim të paraqitet në seancën plenare. Nuk ndodh në asnjë vend të botës së qytetëruar që opozita të mos marrë pjesë në diskutimin për buxhetin e shtetit. Në

pamundësi për të paraqitur një buxhet alternativ, sikurse duhet ta bënte çdo opozitë. Të paktën, opozita është e detyruar që të përfaqësojë atë përqindje të votuesve shqiptarë që i kanë dhënë besimin", - tha Balla. Dy ditë më parë edhe Bashkimi Europian i bëri thirrje opozitës që të zërr vendet e saj në Kuvend dhe ta zhvillojë betejën politike në sallën e seancës plenare dhe të komisioneve parlamentare. BE theksoi rëndësinë e ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të dialogut gjithëpërfshirës politik, ndërkohë që avancohet puna teknike në të gjitha komisionet relevante parlamentare, përfshirë atë në Komitetin ad hoc për reformën zgjedhore.

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHQERORE TIRANE

Kerkon një objekt me qera për ta përdorur për zyra me kriteret e mëposhteme.

1. Siperfaqja e objektit që kerkohet 220-250 m2
2. Document pronesisë mbi objektin (certifikate ose vertetim pronesisë dhe planimetrine)
3. Fondi limit 9 euro për m2
4. Ndertesa të ndodhet brenda vijave kufizuese të qytetit Tirane në një rreze me të vogël se 0.5 km nga ndertesa e DRRSH Tirane.
5. Ambient të kete të instaluar uje dhe energji dhe të kete kushte të pershtatshme për ta përdorur si zyre ose si ambient për dokumenta arkivore, të kete hyrje me vete dhe banjo.
6. Afati i dorezimit të dokumentave do të jete dt 21.11.2018 ora 11.00.
7. Te interesuarit duhet te paraqesin planimetrine, dokument qe vertetojne pronesine dhe oferten ekonomike jo me vone se ora 11.00 te dates 21.11.2018
8. Pasi te dorezohen dokumentacioni, komisioni I ngritur per kete qellim do te beje dhe vleresimin e objektit para shpalljes se fituesit.



Në ditë përpara afatit të fundit për të vendosur mbi kërkesën e dytë të Kryeministrit Edi Rama, për të dekretuar gjeneral Sandër Lleshajn si ministër të Brendshëm, Presidenti i Republikës Ilir Meta shprehet se nuk ndikohet nga presionet. Pak orë përpara skadimit të këtij afati të dytë 7-ditor sipas përcaktimit në Kushtetutë, kreu i shtetit nuk jep një përgjigje për vendimin e tij, por thotë se e di si funksionon Kushtetuta për shkak të karrierës së tij politike. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i ftuar mbrëmë në 'Open' u shpreh se nuk do t'ia lejonte asnjëherë vetes të shkelte Kushtetutën, teksa po fliste për çështjen e dekretimit të kandidatit të Sandër Lleshajt si ministër i Brendshëm.

Z. President përse nuk e dekretuat z. Sandër Lleshaj ministër të brendshëm?

Që ditën që kam pranuar këtë detyrë, e cila është detyra e lartë në vendin tonë dhe kam vënë dorën mbi Kushtetutë kam marrë përsipër të gjithë përgjegjësitë për të respektuar Kushtetutën. Për rastin konkret është krijuar një situatë, por jo nga mua. Jam i bindur që kam vepruar në interes të respektimit të Kushtetutës dhe interesit publik dhe kam për të gjitha përpjekjet e mia për të dhënë një zgjidhje të drejtë. Çështja e emërimit të një ministri, është një çështje që kërkon bashkëpunimin e tri institucioneve, Kryeministrit, Presidentit dhe Kuvendit.

Cila është arsyeja e rrëzimit të dekretit të parë?

Çështja është më e qartë për opinionin pas iniciativës së dytë të Ramës për të propozuar sërish kandidaturën e zotit Lleshi. Pyetjet që unë bëra publike e sqarojnë. Kemi të bëjmë me sqarimin e situatës së ushtararakut dhe ministrit të cilat janë të pajtueshme me Kushtetutë. Unë nuk kam marrë asnjë vendim. Unë po bashkëpunoj për të sqaruar. Ne po vazhdojmë diskutimet aktualisht. Një shkelje e qartë e Kushtetutës është një përgjegjësi e madhe e presidentit.

Si i komentoni deklaratat e kryeministrit Rama në Kuvend për shkelje të Kushtetutës?

S'më shqetëson se e di shumë mirë Kushtetutën e Shqipërisë. Unë u lodha me këto lavdërime, por për fat të mirë apo të keq përsëri vazhdoj të bëj detyrën si më parë, në kuptimin e lartësive së detyrës për të respektuar Kushtetutën. S'kam ndërmend të bëj asnjë dëm se të tregoj kulturën e bashkëpunimit institucional. E rëndësishme mos të shpenzojmë energji për konflikte të panevojshme. Me rëndësi është presidenti të veprojë

Presidenti: Nuk e kam numrin e Ramës. Komunikimet tona bëhen përmes sekretarëve

Ilir Meta: Lleshi, nuk pranoj presione, zbatoj Kushtetutën

“Shkarkimi? S’ka asnjë shans ta lë Presidentcën”

mbi Kushtetutën dhe mos lejojë cenimin e Kushtetutës. Nuk është kryeministri autoriteti që mund të sqarojë këtë situatë. Rasti në fjalë është përgjegjësi e ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit duke qenë se kemi të bëjmë me një gjeneral me gradë madhore.

Z. Lleshaj përmes një letrë dërguar ju ka kërkuar që ta ç’dekretoni... Cila është përgjigjia juaj për të?

Nuk kam arsye t'i përgjigjem drejtpërdrejt. E kam marr letrën e tij, është në tryezën tonë, por mënyra si funksionon zgjidhja është nga Ministria e Mbrojtjes te Presidenti, sepse nëse gjithë gjeneralët sot gjejnë një vend me rrogë 2-3 herë më të lartë dhe lënë ushtrinë dhe presidenti firmos këtë kërkesë, mbetet ushtria pa komandë.

A do ta dekretoni z. Sandër Lleshaj?

Është mjaft e rëndësishme që presidenti të veprojë në përputhje me Kushtetutën. Nuk kam marrë asnjë vendim. Vendimi im është që po bashkëpunojmë. Po vazhdojmë këtë proces me Ministrinë e Mbrojtjes, e cila është ministria përgjegjëse për këtë çështje.



Presidenti i Republikës Ilir Meta, dje në në 'Open'

Një koment tuajin për ministrin e dorëhequr Fatmir Xhafaj?

Bëri përpjekje të rëndësishme për të rivendosur një autoritet të policisë në luftën kundër krimit dhe një ndarje për një periudhë të mëparshme.

Kryeministri Rama deklaroi në një emision televiziv se: "Do la marr Presidentin (Ilir Meta) se e ka mik Gruevskin", si përgjigje ndaj asaj çfarë i tha gazetari Nikoll Lesi: Merr një numër Gruevskit ta kesh rezervë, se s'i dihet...

Unë jo vetëm numrin e Gruevskit nuk e kam dhe as e kam pasur ndonjëherë, por as numrin e Ramës nuk e kam prej disa muajsh pasi kam ndërruar telefon. Po komunikojmë përmes shëfave të kabinetit dhe sekretarëve të përgjithshëm.

A mund t'ju shkarkojë mazhoranca nga posti i Presidentit?

Në këtë situatë që është vendi s'ka asnjë shans të lë Presidentcën se është një institucion tepër i rëndësishëm për të mbrojtur nivelin e demokracisë që është në momente kritike. Ka shumë element që kanë të bëjnë me Shqipërinë civile, me të drejtat e gazetarëve, me të drejtat e sipërmarrjen. Presidenti ka përgjegjësi që të mbrojë liritë. Presidentcën do ta vazhdoj me përgjegjësi maksimale. Para së gjithash interesi kombëtar.

Kush janë përgjegjësit për këtë situatë?

Përgjegjës janë të gjithë ata që mendojnë se shkelja e Kushtetutës s'është ndonjë gjë e madhe. Pastaj edhe qytetarët e kuptojnë kur të drejtat e tyre shkelen.

Të ndalemi pak të ngjarja e "Bularatit"...

Është e rëndësishme të bëhet një analizë e plotë e të gjithë administrimit të një situatë të tillë, pasi duhet të përgatitemi me provokime të tilla, pasi duket se nuk kemi të bëjmë me një rastësi. Këtë e kam thënë për kohësh dhe i kam paralajmëruar shërbimet tona të hapin sytë

"Projekti favorizon objekte të krimit"

Basha: "Unaza e Re" është skenar i një spastrimi etnik!



REZISTENCA

"Nuk mbaj mend që në 20 vite të ketë ndodhur që njerëzve t'i shkohet në shtëpi dhe t'i thuhet diçka. Kjo është një situatë shumë e rëndë. Kjo që po ndodh është një situatë jo normale, sepse kjo mund t'i ndodh çdo njeriu. Në këto kushte mbetet vetëm rezistenca", -tha z. Basha.

që tregon se ata do të prishin dhe shtëpitë e shqiptarëve. Këta kanë shkuar në shtëpitë e mbi 1 mijë familjeve, rreth 317 banesa. Ky është një produkt i një paligjshmërie barbare. Jo vetëm unë jo vetëm politi-

kanët, por kjo është detyrë e çdo institucioni. Është fare e natyrshe që unë si kryetar i opozitës dhe politikanët e tjerë jemi aty për të kërkuar zbatimin e ligjit. Mesa duket projekti ka disa probleme serioze. Janë dhënë

20 milionë euro për 1.9 kilometra në një segment të Unazës. Afera e tenderimit është korruptive, ku janë 3 kompani e 4-ta është futur si bedel, për të përmbushur anën formale të ligjit ku thotë se të tri lotet janë futur pa garë. E zëmë se projekti është në rregull, problemi elementar është zbatimi dhe respektimi i ligjit për pronën. Kjo që po bëjnë këta është skenar i spastrimit etnik, këtë bënë serbët ndaj kosovarëve. Pra, këtu bëhet fjalë për të drejta të patjetërsueshme të banorëve që është shkelur me të dyja këmbët nga organet që duhet t'i mbrojnë", deklaroi Basha.

SHKARKIMI?
"Në këtë situatë që është vendi s'ka asnjë shans të lë Presidentcën se është një institucion tepër i rëndësishëm për të mbrojtur nivelin e demokracisë që është në momente kritike. Presidentcën do ta vazhdoj me përgjegjësi maksimale. Para së gjithash interesi kombëtar", tha z. Meta.

PËR VITORE TUSHËN

"Dua t'i kontribuoj forcimit të pavarësisë së këtij institucioni. Është një institucion që bën vetëgjykimin e të gjithë institucioneve të tjerë në administrimin financiar. Duke qenë se ka një karrierë shumë solide në fushën e drejtësisë, s'ka pasur angazhim në politikë. Është një figurë me shumë integritet, do t'i kontribuonte forcimit të mëtejshëm të pavarësisë në këtë pozicion kyç", - tha z. Meta.



NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
Pasuria nr. 8 / 58 + 1 - 4 , e llojit 'Apartment', volumi 3 , faqe 188, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 75 m2, në bashkëpronësi të ENGJELL LUAN TOPORE dhe NATASHALUMAN TOPORE , me adresë: Rruga "Th. Ziko", Pallati 65 / 3, Tiranë.
ÇMIMI 36.350 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
Pasuria nr. 101 / 8 , "Trull + Ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale 3096, volum 8, faqe 115, me sipërfaqje 3.200 m2, nga të cilat ndërtesa ka sipërfaqje 166 m2, në bashkëpronësi të YAHIA Muhamed Zakaria FARWATI dhe BRIXHILDA Baftjar FARWATI, me adresë: Qerekë, KRUIJE.
ÇMIMI 114.508 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
Pasuria e paluajtshme kolaterale të llojit "Pyl + Kullotë", me sipërfaqje totale 190.000 m2, zona kadastrale 3028, me adresë POROVLORE, në pronësi të hipotekuesit z. FATION UKA.
ÇMIMI 1.149.120 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Lihen në qeli 18 personat e tjerë, mes të cilëve pjesëtarët e fisit Avdyli

"VOL-VO 4"/ Apeli i Krimeve të Rënda liron nga burgu 2 ish-deputetët e PS

Gjykata ndryshoi masën e sigurisë në "Arrest shtëpie"

TIRANË

Dy ish-deputetët socialist, Arben Ndoka dhe Arben Çuko janë liruar nga gjykata afro një muaj pas arrestimit të tyre në kuadër të operacionit të koduar "VOL-VO 4". Treshja gjyquese e Apelit për Krime të Rënda e kryesuar nga gjykatësi Sokol Binaj, ua hoqi prangat nga duart ish-deputetëve në fjalë, pasi vendosi ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest shtëpie". Ndërsa ka lënë në burg të "fortët" e Shijakut, grupin e Avdyllave, të akuzuar për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal.

VENDIMI

Ish-drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Arben Çuko, i dyshuar për korrupsion në transferimin e të dënuarve dhe ish-deputeti i Lezhës, gjithashtu, i dyshuar për përfshirje në skandalin e tjetërsimit të pronave, do të qëndrojnë nën masën e arrestit në shtëpi. Prokuroria këmbënguli që të dy të mbaheshin prapa hekurave, me argumentin se ka prova të forta se ata kanë kryer veprimtari të paligjshme në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, por gjykata e refuzoi këtë kërkesë duke lehtësuar pozitën e ish-ligjvënësve. Trupa gjyquese ndryshoi masat e sigurisë edhe për 8 persona të tjerë, të përfshirë në skemën e tjetërsimit të pronave në Lezhë. Katër prej të dyshuarve u liruan në "Arrest shtëpie", ndërsa katër të tjerë nga "Arrest në shtëpi" që i kishte lënë Gjykata e Shkallës së Parë u lanë nën masën "Detyrim paraqitje". Ndërkaq, 18 personat e tjerë, mes të cilëve pjesëtarët e fisit Avdyli, do të vijojnë të qëndrojnë në qeli. I pranishëm në seancë ishte edhe Astrit Avdyli, i konsideruar si kreu i grupit kriminal me bazë në Shijak, i cili një seancë me parë, bëri edhe deklaratatë surprizë, duke pranuar se kishte miqësi me



Ish-deputetët socialist Arben Ndoka dhe Arben Çuko

OPERACIONI "VOL-VO 4"

Më 22 tetor 2018, Policia e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe në bashkëpunim me agjenci të tjera ligjzbatuese finalizuan një mega operacion të koduar "VOL-VO 4", të shtirë në 12 qytete nga Hasi deri në Sarandë ku u goditën anëtarë nga 4 grupe të skeduar kriminale, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Gjatë këtij operacioni u arrestua ish-deputeti Arben Ndoka, pasi rezultonte i përfshirë në një skemë tjetërsimi pronash Shëngjin, ndërsa ish-deputeti dhe ish-drejtori i Burgjeve Arben Çuko si i përfshirë me pjesëtarët e grupit të Shijakut.

kryebashkiakun e Durësit, Vangjush Dako dhe se kishte punuar për llogari të tij në fushatë. Madje, në mes të seancës ai thirri: Rroftë Vangjush Dako, rroftë Partia Socialiste, janë miqtë tanë, ku ne qajmë hallet. Në kafazin e xhamit ishte ulur dhe Altin Avdyli i njohur me nofkën "Nice" që është përgjuar në biseda telefonike me kryebashkiakun Dako.

Pjesëtarët e fisit Avdyli si dhe të njohurit e tyre, dyshohen për akuzën e trafikut të hashashit, heroinës e kokainës. Prokuroria thotë se ata e kishin shtrirë aktivitetin e tyre kriminal në disa vende të Bashkimit Europian. E ndërsa po përgjonte Avdyllajt për të dokumentuar krimet e tyre, institucioni i akuzës ra në gjurmët e ish-deputetëve socialistë Çuko dhe Ndoka.

MASAT E SIGURISË SË DHËNË NGA APELI

PERSONAT QË U LANË NË BURG	MASAT E SIGURISË SË DHËNË NGA APELI
1-Jasin Kala Abdyl	16-Orgest (Artan) Jajelezi
2-Shkëlqim Avdyli	17-Elis Bahushi
3-Denis Llaftiu	18-Artur Balla
4-Fatos Llaftiu	NE "ARREST SHTËPIE"
5-Hajri Seferi	1-Arben Cuko
6-Petro Abedin Kuci	2-Arben Ndoka
7-Illirjan Prifti	3-Elis Guri
8-Elton Shehaj	4-Zef Lazri
9-Armand Spiro	5-Paulin Simoni
10-Astrit Avdyli alias Astrit Balliu alias Astrit Sulejmani	6-Ardit Gjyriqi
11-Altin Avdyli	"DETYRIM PARAQITJE"
12-Saimir Gjepali	1-Lule Zeneli
13-Xhevi Ndoka	2-Zef Paloka
14-Esat Mehmeti	3-Vasil Nika
15-Saimir Sulejmani	4-Gent Zeneli

Vendimi, PD: Lirimi i dy ish-deputetëve, me firmën e Ramës

TIRANË - Partia Demokratike e ka cilësuar një vendim politik, lirimin nga burgu të dy ish-deputetëve socialistë Arben Ndoka dhe Arben Çuko. Në një deklaratë për mediat, kjo forcë politike thekson se ky nuk është vendim i drejtësisë së pavarur. "Kjo është e njëjta skemë që Edi Rama përdori me Saimir Tahirin për të mashtuar partnerët: i arreston me bujë dhe i liron e ju mbyll dosjet në heshtje. Me lirimin nga burgu të numrit 1 të Partisë Socialiste në Lezhë, që sundon me dhunë, krim dhe korrupsion, u rikonfirmua bindja e opozitës dhe shumicës së shqiptarëve se Forca e Ligjit nuk ekziston në Shqipëri dhe se ata që blejnë vota për Edi Ramën, ata që vjedhin për pushtetin ilegjitim të Edi Ramës qëndrojnë mbilgim", theksohet në deklaratën e PD-së. Edhe në këtë rast, partia më e madhe në opozitë kërkon arrestimin e Vangjush Dakos, pasi sipas saj është pjesë e dosjes 339.

Vetingu, shkarkohet prokurori që hetoi Fullanin e Gjickën

TIRANË - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar dhe nga detyra prokurorin Ramadan Troci, duke mos kaluar kështu vetingun, pasi i janë gjetur disa shkelje në deklaratimin e pasurisë. Troci, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë ishte ai që hetoi dhe arrestoi ish-governatorin Ardian Fullanin dhe ish-kryebashkiakun e Vlorës Shpëtim Gjika. Nga hetimi janë konstatuar problematika në pasurinë që zotëron subjekti i rivlerësimit. ILDKPI ka rielatuar se Troci ka burime të mjaftueshme financiare, por ka fshehur pasurinë. Bëhet fjalë për një ndërtesë 32 m2 në zonën e Paskuqanit, por Troci tha se ajo i përket babait të tij dhe se ai vetë nuk ka pasur asnjëherë dijeni për të. Problematikë është evidentuar edhe fakti që prokurori jeton në një apartament në zonën e Pazarit të Ri, që sipas Trocit i përket një mikut të tij, i cili ia ka lënë me qira. Sa i përket figurës morale, Ramadan Troci rezultoi i pastër, pasi nuk janë gjetur lidhje të tij me personazhe të papërshtatshme me botën e krimit të organizuar.

SHKURT

Shpifi për Shkëlzen Berishën, gjykata dënnon ish-juristin e CEZ

TIRANË - Gjykata e Tiranës ka shpallur dje fajtor për shpifje ish-juristin e CEZ, Romeo Kara. Togat e zeza të kryeqytetit e kanë cilësuar fajtor dhe e kanë dënuar me 500 mijë lekë të vjetra Romeo Kara për deklaratën e bërë në "Facebook" në vitin 2017, ku shkruante se djali i ish-kryeministrit Sali Berisha ka bërë trafik droge. Ai është dënuar me gjobë për veprën penale "Shpifje e kryer botërisht". Por vetë Kara ka deklaruar se e kishte huazuar akuzën nga një intervistë televizive e Izet Haxhijait në vitin 2014. Izet Haxhia e akuzonte Shkëlzen Berishën se ishte përfshirë në trafik droge. Por Shkëlzen Berisha u kundërpërgjigj dhe e përgënjeshtroi Haxhijait dhe tha se nuk mund të çonte në gjyq një vrasës. Të njëjtat akuzë i ka përmendur Kara, të cilin Shkëlzen Berisha e ka akuzuar për shpifje.

Probleme me pasurinë, KPK shkarkon gjyqtaren Alma Liçaj

TIRANË - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar dje gjyqtaren e Vlorës, Alma Liçaj, Liçaj, që mbante postin e kryetares së Gjykatës së Vlorës, nuk e ka kaluar vetingun, pas problemeve me pasurinë. KPK zhvilloi të martën seancën dëgjimore për kryetaren e Gjykatës së Apelit të Vlorës, ndërsa hetimi ishte kryer vetëm në një kriter të rivlerësimit, atë të pasurisë. Ajo u paraqit e vetme në ambientin e KPK, por një avokat mbrojtës dhe nuk foli gjatë seancës së treditëvite me parë, por i tha komisionit se nuk kishte gjë shtesë përveç atyre që kishte argumentuar në materialin me shkrim të depozituar në KPK. "Nuk kam diçka për të thënë, i qëndroj shpjegimeve me shkrim që i kam depozituar", u shpreh ajo.

Ra nga ura me makinën e mbushur me hashash, vdes 34-vjeçari

LEZHË - Një 34-vjeçar nga Lezha ka humbur jetën në një aksident rrugor, ndërkohë që në mjet ka pasur edhe drogë. Ngjarja në fjalë ka ndodhur gjatë natës të së mërkurës në rrugën rurale që lidh fshatrat Kaçinar-Mirditë-Kaluer. Burime zyrtare nga policia thanë për "GSH" se bëhet fjalë për Tonin Ndreçën, i cili për t'i shpëtuar pikasjes nga policia ecte me shpejtësi, e për pasojë është përfshirë në një aksident. Të njëjtat buri thanë se 34-vjeçari ka humbur kontrollin e mjetit duke rënë poshtë urës dhe për pasojë ka humbur jetën. Mësohet se në makinë, policia ka gjetur dhe sekuestruar 80 kg kanabis.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQUERUAR ME FTESA DIREKTE

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 45,610,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), gdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktueshme prej 500 Lekë, pranë një bankë tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 20 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e paktueshmit të tyre.

Merren në pyetje 40 persona. Familjarët e viktimës: S'kemi konflikte me askënd

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një ditë pas ekzekutimit me plumb në kokë të 40-vjeçarit Fatos Ferracaku dhe plagosjes së kunatit të tij 48-vjeçar Fatmir Mehaj, puna në markatën e lagjes "Rus" në Shkodër ka nisur normalisht. Tregtarët që shesin prodhimet e tyre janë rikthyer duke vijuar aktivitetin për të siguruar të ardhurat për familjet e tyre. Shumë prej atyre dëshmitarëve që ishin të pranishëm në momentin kur u qëllua për vdekje Ferracaku nuk pranuan që të rrëfejnë ngjarjen në fjalë. Tejet të frikësuar, ata refuzuan të prononcohen duke kërkuar të mos thonë asnjë fjalë. Edhe pse një pjesë e mirë kanë qenë aty duke shitur produktet e ndryshme si çdo ditë tjetër, ata thanë të kundërtën duke mohuar se kanë qenë aty apo se e kanë parë momentin e vrasjes. Madje shumë prej dëshmitarëve pohuan se nuk e kanë njohur fare viktimën dhe kunatin e këtij të fundit, edhe pse që të dy çdo ditë shisnin peshk tek markata e Rusit, vendi ku ndodhi ngjarja e rëndë. Jo vetëm shitësit, por edhe kalimtarët e rastit, shumë prej të cilëve rrezikuan nga 8 plumbat e nxjerrë nga pistoletat e atentatorit, preferuan heshtjen për shkak të frikës. Ndërsa të gjithë bënin sikur nuk kanë parë e dëgjuar asgjë edhe pse atentati ndodhi në mes të ditës, lokali ku ishin duke pirë kafe Fatos Ferracaku dhe Fatmir Mehaj ishte i hapur. Klientët e përditshëm të asaj kafeneje të vogël kanë vijuar që të kalojnë kohën si zakonisht të pandikuar shumë nga plumbat rrëke të një dite më parë. Ndërsa, vesheshin re me sy të lirë shenjat e plumbave në pjesët metalike të kafenesë apo edhe në tokë. "Na ka shpëtuar Zoti", u shpreh njëri prej tyre, por pa dashur që ta zgjasë më shumë apo që më tepër që të identifikohet me emrin e tij. Ndërkaq, ngjarja e rëndë ka alarmuar policinë e Shkodrës, e cila në bashkëpunim me prokurorinë po hetojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Burime nga policia e qytetit verior bënë me dije se në lidhje me atentatin janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 40 persona. Mësohet se mes të shoqëruarve ishte dhe anëtar i këshillit bashkiak të Shkodrës, Mustafa Lici, vëllai i Fatbardh Licit, i cili u ekzekutua në një tjetër atentat në Shkodër, të ndodhur më 10 gusht të këtij viti. Ndërkaq, gjatë marrjes në pyetje familjarët e viktimës kanë deklaruar para bluve se nuk kanë konflikte me askënd.

HETIMI

Ngjarja e ndodhur dy ditë më parë në lagjen "Rus" ka dërguar djathtë në Shkodër zyrarë të lartë të Policisë së Shtetit. Në këtë qytet ka mbërritur me urgjencë drejtori për krimet e rëndë në Policinë e Shtetit, Niko Bra-

Ekzekutimi i Fatos Ferracakut, tregtarët e markatës në Rus nën terror: Na ka shpëtuar Zoti

Shoqërohet dhe lirohet pas 8 orësh këshilltari bashkiak. Fatbardh Lici: S'kam lidhje me vrasjen dhe me motorin



40-vjeçari i vrarë, Fatos Ferracaku



Vendi ku ndodhi atentati



Këshilltari bashkiak, Fatbardh Lici

Atentati me një të vrarë e një të plagosur, ish-Presidenti Nishani: Shkodra peng i krimit

SHKODËR - Ish-Presidenti i Republikës Bujar Nishani mori pjesë dje në Shkodër në konferencën shkencore "Shkodra në vitet e komunizmit 1945-1953" e organizuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër. Në fillim të fjalës së tij ish-kreu i shtetit deklaroi se "për fatin e keq Shkodra kohët e fundit po na paraqitet si qytet ku individë apo grupe të caktuara individësh s'kanë asnjë lidhje jo vetëm me traditën, por edhe me realitetin e qytetarisë dhe civilizimit, kulturës, emancipimit, zhvillimit dhe duket sikur e kanë marrë peng përkohësisht jetën e



këtij qyteti, lirinë e këtij qyteti, të drejtat e qytetarëve dhe sigurinë e qytetit. Gjithsesi, pavarësisht kësaj situatë që unë besoj se është momentale dhe do të tejkalohet, Shkodra mbetet një simbol

shumë i madh". Pas këtij takimi duke folur për mediat, ish-Presidenti Nishani tha se "fakti që vetëm para dy ditësh nga një vendim i Gjykatës së Krimeve të Rënda që u dha në Tiranë kundër Shullazit, pati prononcime zyrtare të disa ambasade kryesore në Shqipëri, si SHBA, Britani, BE, e një sërë institucionesh të tjera ndërkombëtare u angazhuan duke e vlerësuar si një hap të parë, kjo flet sa një mijë deklarata politike. Fakti që faktori ndërkombëtar është kaq i shqetësuar sa bën deklaratat për një grup kriminal, kjo mjafton".

DËSHMIA E KËSHILLTARIT

Fatbardh Lici ndodhej në banesën e tij në afërsi të Zooteknikës, kur FNSH me efektivë të maskuar kanë rrethuar fillimisht banesën dhe më pas kanë bërë shoqërimin e tij në komisariat. Në polici ai është pyetur rreth vrasjes së Fatos Ferracakut dhe motorit që u gjet i djegur në afërsi të banesës së tij, por Mustafa Lici ka mohuar se ka lidhje me ngjarjen apo se ka dijeni për autorët e mundshëm si dhe është shprehur se nuk ka dijeni as për motorin e djegur. Sipas tij, kur ka ndodhur atentati, ai ndodhej në Tiranë me deputetë të PD-së në një mbledhje

ke ka qenë ngjyre gri, tip TMAX 550 kubik, mjet që ka një shpejtësi të madhe. Ndonëse në vendin ku ndodhi krimi i rëndë ka pasur shumë njerëz, autori nuk ka gabuar në asnjë prej plumbave. Në vendin e ngjarjes mësohet se ka qenë rastësisht edhe një efektiv i policisë, civil në ato momente, ndërsa ai ka tentuar që ta ndjekë autorin duke vrapuar, por motori është larguar me shpejtësi. Edhe personi që drejtonte motorin ka pasur skafandër në kokë, ndërsa ka qenë i veshur me rroba ngjyrë gri.

SHOQËRIMI I KËSHILLTARIT LICIT

Policia e Shkodrës, dje ka shoqëruar Mustafa Licin, anëtar i Partisë Mendimi i Djathtë Liberal në Këshillin Bashkiak të këtij qyteti. Burimet bënë me dije se Lici u shoqërua që në orën 06:00 të mëngjesit. Ai ndodhej në banesën e tij në afërsi të Zooteknikës, kur FNSH me efektivë të maskuar kanë rrethuar fillimisht banesën dhe më pas kanë bërë shoqërimin e tij në komisariat. Në polici ai është pyetur rreth vrasjes së Fatos Ferracakut dhe motorit që u gjet i djegur në afërsi të banesës së tij, por Mustafa Lici ka mohuar se ka lidhje me ngjarjen apo se ka dijeni për autorët e mundshëm si dhe është shprehur se nuk ka dijeni as për motorin e djegur. Sipas tij, kur ka ndodhur atentati, ai ndodhej në Tiranë me deputetë të PD-së në një mbledhje. Pas shoqërimit familjarët e këshilltarit të Bashkisë nuk janë lejuar që të kenë asnjë lloj kontakti me të. Ata kanë kërkuar që t'i dërgojnë ujë dhe ushqime, por kjo gjë nuk është pranuar nga policia. Mustafa Lici u la i lirë pas 8 orësh që u mor në pyetje në policinë e Shkodrës.

EKZEKUTORI

Nga atentati që tronditi Shkodrën kanë dalë edhe disa detaje të tjera. Burime nga vëndngjarja thanë se autori i vrasjes ka pasur të veshur një xhakete ngjyre të kuqe me të bardhë, ndërsa në kokë mbante një skafandër të kuqe. Autori është ulur nga motori shumë shpejt dhe është afruar deri në rreth 10 metër. Ai ka qëlluar në ecje e sipër. Pasi ka qëlluar objektivin Fatos Ferracaku, i është afruar dhe e ka qëlluar edhe dy here të tjera në kokë viktimën për t'u siguruar se ka vdekur.

himaj, nëndrejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe drejtor për Rëndin, Gjovalin Loka, njëkohësisht ish-drejtor në policinë vendore të Shkodrës dhe një prokuror i Krimeve të Rënda. Fillimisht po analizohet nëse ngjarja duhet të bashkëlidhet në një procedim për tek Krimet e Rënda në kryeqytet apo do i lihet organit të akuzës në Shkodër. Po ashtu krerët e lartë mbërritën në policinë vendore të Shkodrës edhe për të analizuar

dhe thelluar hetimet lidhur me ngjarjen e rëndë për zbardhjen e plotë të saj. Ende policia nuk ka asnjë autor të dyshuar për vrasjen e Fatos Ferracakut dhe plagosjen e Mehajt, të cilët u qëlluan nga një person ndërsa një tjetër e priste atë me motor dhe pak pas krimit u larguan nga vendi i ngjarjes. Momentalisht policia nuk ka as pista hetimi se përse u vra 40-vjeçari Ferracaku. Motori i autorëve të krimit që u gjet i

djegur në zonën periferike të Zooteknikës rezultoi i paregjistruar në sistem. Nga atentati që tronditi Shkodrën kanë dalë edhe disa detaje të tjera. Burime nga vëndngjarja thanë se autori i vrasjes ka pasur të veshur një xhakete ngjyre të kuqe me të bardhë, ndërsa në kokë mbante një skafandër të kuqe. Autori është ulur nga motori shumë shpejt dhe është afruar deri në rreth 10 metër. Ai ka qëlluar në ecje e sipër. Pasi ka qëllua-

ar objektivin Fatos Ferracaku, i është afruar dhe e ka qëlluar edhe dy here të tjera në kokë viktimën për t'u siguruar se ka vdekur. Autori ka qëlluar vetëm me një rëndë dorë, ndërsa raportohet se ka pasur një saktësi të madhe duke qenë preciz, pra një vrasje profesioniste. Më pas është larguar duke hipur në motor, që drejtohej nga një tjetër person. Sapo ka hipur në motor, autori ka qenë duke futur pistoletën brenda, por më pas ka qëlluar edhe njëherë në ajër për të dhënë ndoshta edhe një mesazh. Në duar mbante doreza të zeza për të mos lënë asnjë gjurmë. Gjatë kohës kur qëlloi, autori e ka pasur xhamin e skafandër të hapur, por nën të sipas burimeve mbante një kapuç, pra ka qenë i maskuar. Sipas burimeve motori që u gjet duke u djegur në Zootekni-

Edhe pse kishin kalu marra e detyrës, zëvendësministri i Arsimit, Sportit e Rinisë, Taulant Muka ditën e djeshme ka dhënë dorëheqjen. Ai u emërua në këtë detyrë më 31 tetor, ndërsa zëvendësoi Ervin Demos, i cili dha dorëheqjen pasi u akuzua për plagjiaturë. Muka i ka dorëzuar dorëheqjen kryeministrit Edi Rama, duke vënë në dijeni edhe ministrin e Arsimit, Lindita Nikolla, ku i paraqiste edhe arsyet e dorëheqjes. "Për arsye etike, morale dhe profesionale, dhe të papajtueshmërisë që unë kam me modelin e punës të aplikuar me Ministrinë e Arsimit, ju paraqes dorëheqjen time të përvokueshme nga posti i zv. ministrit", thekson Muka në letrën e dorëheqjes, drejtuar Ramës. Më tej ky i fundit sh-ton se dashurinë për arsimin nuk e ndërron me asgjë. "Dashurinë për arsimin, shkencën dhe Shqipërinë nuk e ndërron me asgjë!", shkruan

"Dashurinë për arsimin nuk e ndërron me asgjë"

Zv ministri i Arsimit, Muka jep dorëheqjen: Nuk pajtohem me modelin e punës së MASR

DORËHEQJA

Muka i ka dorëzuar dorëheqjen kryeministrit Edi Rama, duke vënë në dijeni edhe ministrin e Arsimit, Lindita Nikolla, ku i paraqiste edhe arsyet e dorëheqjes. "Për arsye etike, morale dhe profesionale, dhe të papajtueshmërisë që unë kam me modelin e punës të aplikuar me Ministrinë e Arsimit, ju paraqes dorëheqjen time të përvokueshme nga posti i zv. ministrit", thekson Muka.

ministrin", thekson Muka në letrën e dorëheqjes, drejtuar Ramës. Më tej ky i fundit sh-ton se dashurinë për arsimin nuk e ndërron me asgjë. "Dashurinë për arsimin, shkencën dhe Shqipërinë nuk e ndërron me asgjë!", shkruan

Muka në faqen e tij në rrjetin social "Facebook".

LARGIMI I ERVIN DEMO

Ardhja në këtë detyrë e Mukës u shoqërua me debate të mëdha, pasi ishte ai që akuzoi ish-zëvendës ministrin e arsimit, Ervin Demo për

plagjiaturë. Por pak javë pas dorëheqjes së Ervin Demos, Muka mori postin e zv. ministrit me emërim të kryeministrit Edi Rama. Studiuat denoncoi plagjiaturën që sipas tij zv. ministri i Arsimit Ervin Demo kishte bërë në



Taulant Muka

Faksimili e dorëheqjes së Taulant Mukës

një artikull me titullin "Universitetet dhe transferimi i teknologjisë", i botuar në vitin 2011. Ndërkohë Demo teksa theksoi se ishte vënë në shënjestër nga politika e baltes, u shpreh pas dorëheqjes se çdo argumentim i tij do të

paragjykohej. "Çdo argumentim nga ana ime kundër baltes në pozicionin që jam sot, do të paragjykohej vetiu dhe do linte vend për keqinterpretime, nëse unë do të mbetesh në pozicionin tim", tha Demo disa kohë më parë.

5 hapat për t'u bërë pjesë e universiteteve amerikane. Kriteret dhe aplikimi

Studimet në SHBA, ambasada: Kujdes, nuk mund të punoni për të paguar tarifën

"Duhet të keni patjetër sponsor, kursime apo bursë"

Të gjithë ata që janë të interesuar për të ndjekur një program studimi në Shtetet e Bashkuara, duhet të dinë se nuk mund të punojnë në tokën e premtuar për të financuar studimet. Ditën e djeshme, ambasada amerikane, nëpërmjet një njoftimi ka bërë me dije se studentët duhet të kenë një bursë, një sponsor ose kursime për të paguar tarifën e shkollimit në një prej universiteteve amerikane. "Të studiosh në SHBA është një mundësi e shkëlqyer, por nuk mund të punoni në Shtetet e Bashkuara për të financuar arsimimin tuaj. 'Education USA' është vendi i duhur ku mund të hartoni një plan për të paguar shkollimin tuaj në Shtetet e Bashkuara. Ju nuk mund të punoni jashtë kampusit për të paguar tarifën e shkollës. Duhet që të keni kursime, një sponsor ose ndihmë financiare/bursë për të paguar arsimimin tuaj", thekson ambasada në njoftimin e saj.

HAPAT PËR STUDIME NË SHBA

Sot është dita e fundit e festimit të javës së arsimit ndërkombëtar, e cila vjen si një mundësi për përfitimet e arsimit ndërkombëtar dhe shkëmbimeve në të gjithë botën. SHBA-të renditen të katërta nga destinacionet e zgjedhura nga studentët shqiptarë që po studiojnë jashtë Shqipërisë. Qendra 'Education USA' është një zyrë këshillimi për të gjithë ata të interesuar që duan të vazhdojnë studimet në Amerikë. 'Education USA' është një program i Departamentit të Shtetit Amerikan dhe financohet nga ta dhe ambasada amerikane në Tiranë. Këshilluesja e qendrës 'Education USA' mund t'ju këshillojë dhe t'ju asistojë gjatë ndjekjes së 5 hapave për të studiuar në SHBA. Të gjithë të interesuarit duhet të gjejnë universitetin apo kolegjin që plotëson të gjitha kushtet e aplikantit. Me mbi 4500 univer-



Ambasada e SHBA-ve në Tiranë

sitete apo kolegje në Amerikë, nuk duhet të përpigjeni të përshtatni veten me shkollën, por të gjeni shkollën që ju përshtatet juve dhe qëllimeve tuaja. Kërkimi duhet të fillojë 12-18 muaj para vitit akademik në

të cilin doni të vazhdoni studimet. Secili universitet apo kolegji ka kriteret e veta. Duhet të jepni provimet e standardizuara në bazë të ciklit të studimit që doni të vazhdoni dhe kërkesave të universitetit apo kolegjit.

BURSAT

Kandidatët duhet të ndjekin edhe financimin e investimeve. Megjithatë, konkurrenca është e lartë, çdo vit studentët ndërkombëtarë marrin shumë të konsiderueshme në ndihmë financiare apo bursa

KUSHTI

"Të studiosh në SHBA është një mundësi e shkëlqyer, por nuk mund të punoni në Shtetet e Bashkuara për të financuar arsimimin tuaj. 'Education USA' është vendi i duhur ku mund të hartoni një plan për të paguar shkollimin tuaj në Shtetet e Bashkuara. Ju nuk mund të punoni jashtë kampusit për të paguar tarifën e shkollës".

Nuk ka proces standard aplikimi, pasi secili universitet apo kolegji ka kriteret e veta dhe afatet e veta të aplikimit. Aplikimi fillon gjithmonë një vit përpara vitit akademik ku doni të studioni. Procesi mund të përfshijë shkrimin e një esaje, mbledhjen e letrave të rekomandimit, certifikatat apo vërtetimet e aktiviteteve jashtëshkollë dhe pikët e provimeve. Pasi pranohen nga universiteti dhe merrni dokumentin e pranimit, duhet të aplikoni për vizën studentore. Bëhet aplikimi 'online' duke plotësuar formularin, pagesën dhe rezervim të datës së intervistës. Hapi i fundit është takimi para largimit nga Shqipëria. Qendra bën një takim informues mbi jetën studentore dhe çdo gjë tjetër që ju duhet të dini para se të nisni për në Shtetet e Bashkuara.

10 milionë turistë, sfida e Ministrisë së Turizmit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është vendosur që të arrijë numrin e 10 milionë turistëve që do të vizitojnë Shqipërinë vitin e ardhshëm. Për këtë, ministria në fjalë synon ndërtimin e një mekanizmi të ri në zbatim të politikave që mbrojnë mjedisin dhe për rrjedhojë promovojnë turizmin. Deri më tani ka pasur disa rezultate konkrete në terren, si mblylla e gurore të paligjshme, eliminimi i përdorimit të qeseve plastike të pariciklueshme apo vendimi që ndalon importimin e makinave me mbi 10 vite përdorim, si një nga industritë që ndot më shumë ajrin. Në tetor

ministria e Turizmit dhe e Mjedisit zbardhi një plan prej 365 masash për 365 ditët e vitit të ardhshëm turistik, ku evidentohet problematika me qëllim përmirësimit të tyre në 2019-n. "Sfida jonë është të realizojmë 10 milionë turistë dhe për të arritur këtë kemi përgatitur një listë me problematika. Diskutuan sot me partnerët e ministrisë për të ndërthurur mekanizma të vërtetë, të cilët kontrollojnë zhvillimet turistike në këto zona dhe po ashtu afrojnë brenda ekspertiencës që kanë Kombet e Bashkuara në shumë aspekte sesi mjedisi të mbrohet dhe turizmi të zhvillohet", tha ministri Klosi.



KËSHILLI BASHKIAK MBLEDHJA

Opozita bojkoton mbledhjen, del në krah të protestuesve të zonës së "Astirit"

Këshilli bashkiak miraton bonusin e strehimit për 85 familje në nevojë

Aprovohet edhe ndihma ekonomike për të varfrit e PAK

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, në një kohë që banorët e Astirit po protestonin, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të Tiranës, çka është shoqëruar me bojkotim nga ana e opozitës. Kjo e fundit iu bashkua qytetarëve që po protestonin jashtë bashkisë, e kanë kërkuar dëshmëri për çdo banesë që do shembet. "Këshilli është pranë qytetarëve! Dëshmëri për çdo banesë! Grupi i këshilltarëve të LSI dhe opozita e bashkuar në Bashkinë e Tiranës bojkotuan mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe iu bashkuan qytetarëve të zonës së 'Astirit', banezat e të cilëve do të shemben nga projekti i Unazës së Madhe. Grupi i LSI në vizionin e tij beson se institucioni i këshillit është pranë qytetarëve dhe jo në salla! Këshilltarët janë votuar dhe mandatar për të zgjidhur çdo problem dhe shqetësim të komunitetit të qytetit tonë", - thuhet në deklaratën e grupit të këshilltarëve të LSI-së. Ky i fundit thekson se kërkon me vendosmëri që të dëshmëri për çdo sakrificë dhe shpenzim ekonomik për çdo banesë, duke respektuar të drejtat e qytetarëve dhe të pronës të garantuara nga Kushtetuta, ligjet dhe Konventat Europiane, si edhe të bëhen transparente dhe publike për qytetarët detajet e projektit të Unazës së Madhe. "Mundi dhe djersa e çdo shqiptari të ndershmëri që kanë ndërtuar shtëpitë për familjet dhe fëmijët e tyre, meriton të dëshmëri për drejtësi, pasi të gjithë qytetarët që kanë ndërtuar në këto 28 vjet duhet të trajtohen dhe të ndihen të barabartë përpara ligjit dhe shtetit të së drejtës. Grupi i LSI si në të kaluarën, edhe në këtë rast, garanton opinionin, se do të jetë pranë interesave të qytetarëve, duke mbështetur kërkesat e drejtat të banorëve të 'Astirit' dhe do bëhet mburojë e interesit publik, duke penguar çdo veprim në interes të oligarkëve", - theksohet më tej në deklaratë.



Këshilli Bashkiak

85

FAMILJE BONUS STREHIMI

Ndërkohë, 85 familje të kryeqyteti do të kenë mundësi që me vendimin e djeshëm të mund të marrin një bonus për përballimin e qirave të shtëpive, ndërsa disa familje të tjera morën ndihmë financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme.

6%

PROGRAMI I NDIHMËS EKONOMIKE

Anëtarët e Këshillit Bashkiak miratuan edhe vendimin për kompensimin e çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese, gjatë periudhës 1-31 tetor 2018, si dhe atë për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind.

opozitës, në mbledhjen e djeshme janë miratuar plot 20 vendime, ndër to edhe ndihma ekonomike për familjet në nevojë si dhe pagesa për personat me aftësi të kufizuara. Në mungesë të kryetarit të bashkisë, Erion Veliaj, në

mbledhje ka qenë i pranishëm nënkryetari Andi Seferi. E vetmja pikë që pati diskutime ishte ajo që lidhej me miratimin e marrëveshjes paraprake midis Bashkisë së Tiranës dhe subjektit "Alis-ndërtim" sh.p.k, për ndërtimin e një

VENDIMET E MIRATUARA NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT BASHKIAK:

- Vendim "Për propozim për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30.11.2018".
- Vendim "Për miratimin e pagesës për PAK e invalidët e punës për periudhën 1-30 nëntor 2018".
- Vendim "Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, për kategoritë përfituese, gjatë periudhës 1-31 tetor 2018".
- Vendim "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i bashkisë Tiranë, për periudhën 1-31 tetor 2018".
- Vendim "Për miratimin e sistemit të fëmijës, E.S, pranë Qendrës së Zhvillimit Pëllumbat, Tiranë".
- Vendim "Për dhënie e ndihmës financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, për disa familje që banojnë në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë".
- Vendim "Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë".
- Vendim "Për miratimin e kompensimit ushqimor për fëmijët e familjeve në nevojë në shkollat ku po implementohet projekti pilot "Bëjmë deturat e shtëpisë" nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë".
- Vendim "Për mbylljen e përkohshme të Qendrës Sociale "Shtëpia e Përbashkët".
- Vendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmësëm 2018- 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, i ndryshuar".
- Vendim "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës".
- Vendim "Për shqyrtimin dhe miratimin e listës së sipërfaqeve të tokave bujqësore të pandara në Njësitë Administrative Zall- Herr, Pezë dhe Shëngjergj të gatshme për t'u dhënë me qira".
- Vendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.39, datë 23.05.2016 e Këshillit Bashkiak "Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja (i ndryshuar)".
- Vendim "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të disa pronave të paluajtshme shtetërore, që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e infrastrukturës".
- Vendim "Për miratimin e procedurës së vlerësimit, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të teknikës së transportit në inventar të Bashkisë Tiranë".
- Vendim "Për dhënie e miratimit për vendosjen e memorialit të Holokaustit në Parkun e Madh të Liqenit Artificial, Tiranë".
- Vendim "Për emërtimin e rrugës "Aliqi Boshnjaku".
- Vendim "Për emërtimin e Rrugës "Kujtim Hysi".
- Vendim "Për vendosjen e një pllake për kujtimore në Njësinë Administrative Baldushk".
- Vendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.31, datë 31.05.2004 të Këshillit Bashkiak Tiranë "Për Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë".

godine disakatëshe në funksion dhe favor të Bashkisë së Tiranës, që është rikthyer për rishqyrtim. Gjithashtu, anëtarët e Këshillit Bashkiak miratuan edhe vendimin për kompensimin e çmimit të energjisë elektrike për kate-

goritë përfituese, gjatë periudhës 1-31 tetor 2018, si dhe atë për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind. **BONUS I STREHIMIT** Ndërkohë, 85 familje të

kryeqyteti do të kenë mundësi që me vendimin e djeshëm të mund të marrin një bonus për përballimin e qerazës së shtëpive, ndërsa disa familje të tjera morën ndihmë financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme.

NJOFTIM ANKANDI

Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lg. "Oemal Stafa" Rr. "Don Bosko", përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se nga data 12.11.2018 ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i tete për shijen e pasurisë së paluajtshme e llojit: **Ndertesë, Kati i pare i perbere nga dy dhoma, banjo, koridor, sallone dhe ballkon me sip. 123 m2, me nr. rradhor 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne z.k.8992 Lg. "Naim Gjylbegu" Rr. Sali Nivica Shkoder ne vleren 3.295.536 leke (Tremilion e pesëqind e nentëdhjetë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë leke)**

Personat e interesuar duhet të derdhin fillimisht shumën prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarren ne ankand)

Oferuesit te drojtohen prane Zyres se Permbueses Gjyqesore Ermira Mhilli, ose te kontaktojne nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emaili. ermira.mhilli@hotmail.com

NJOFTIM ANKANDI

Permbuesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lg. "Oemal Stafa" Rr. "Don Bosko", përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se nga data 12.11.2018 ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i tete për shijen e pasurisë së paluajtshme e llojit: **Ndertesë, Kati i perbere nga ndryje Dyqan, me sip.113 m2, me nr. rradhor 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne z.k.8992 Lg. "Naim Gjylbegu" Rr. Sali Nivica Shkoder ne vleren 2.972.895 leke (dy milion e nentëqind e shtatëdhjetë e dyqind e teteqind e nentëdhjetë e pese leke)**

Personat e interesuar duhet të derdhin fillimisht shumën prej 10% te vleres si garanci ne Raiffeisen Bank (per pjesmarren ne ankand)

Oferuesit te drojtohen prane Zyres se Permbueses Gjyqesore Ermira Mhilli, ose te kontaktojne nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emaili. ermira.mhilli@hotmail.com

Shitje me Ankand te tete nga Studio Permbarimore L.D.C

1. "Ndertesë", me sipërfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, fage 83, ndodhur ne Zonen kadastrale 3426 me adrese ne Tufine, Tirane. Regjistruar ne Zyrën Vendore Regjistrimit Pasurive Paluajtshme Tirane, **Gjimi fillëstar për shitje është 2.116.800 leke.**

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Mystym Shyri" Vila 01, kati 1 Tirane.


REPUBLICA E SHQIPËRISË
GYKATAKUSHTETUESE
KOLEGJII POSAÇËM I APËLIMIT
RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rrvlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESA TË POSAÇËM:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip - Anglisht - Shqip;
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.


Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 21 nëntor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 nëntor deri më 21 nëntor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njëjshura me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.


Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com


REPUBLICA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOHSHME" TË KRIJUAR NË VENDIN GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/d pikat 2, 96 pika 4 shtojnë "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësimin e organit të emërtësës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësimin e organit të emërtësës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakohshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. **Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

Presidenti i Republikës fton:

Cdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefon/ email);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësimin e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, me postë gjëni të botuar përmblajen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesor ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një

veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

Neni 7/a
Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:
 - të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
 - të mos ketë ushtuar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit;
 - të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
 - të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.
- Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
 - të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
 - të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
- Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
 - vjetërsisë në profesion;
 - përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
 - kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - traguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - ecunisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerhme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.
- Organet e emërtësës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimit e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruar mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Biv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dojet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e emërimit e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
Numri telefonit: 042389898

Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit , pjesa e VI

5.700 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërbllim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Të gjithë personat kanë afati deri më



9 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.
DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërme të vetme në krahasim me vetmësinë e

trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medocemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkryra e gjendjes civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq.

EMRAT ME PERFITUESIT E KOMPENSIMIT TE TE PERNDJEKURVE

NR. DOSJES	EMER	MBEMER	EMER	ATENA	MBEMER	KOPIJE TE LETER SHQIPTAR	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VOTORE	CERTIFIKATE E TRINGULET FAMILJARE	DESIMI TRASHIGIME	PRO-KURIE	CERTIFIKATE GJENDJES CIVILE
3210	LOLI	DHAMANDER	MARTA	LOLI	DHAMANDER							
172	AVNI	ZHETI	LEBI	AVNI	MVRTIQA							
881	SAMI	PASHAJ	BEHARE FATJANA	AGUSH PASHAJ	OSMANELLI							
7685	XHEHAL	NIREU	AVNI NIREU	XHEHAL NIREU	NIREU NIREU							
11403	ISUF	NRCA	BARBE ISUF	ISUF NRCA	ISUF NRCA							
603	GIJOKE	DMACAJ	ANTONI GIJOKE	DMACAJ	GIJOKE							
7841	ETHEM	BAKALLI	GHIMAN ETHEM	BAKALLI	BAKALLI							
8521	ALEKS	CEMI	LETRIMIA ALEKS	CEMI	CEMI							
11355	SYRJA	GOLJA	AGRON SYRJA	GOLJA	GOLJA							
10822	GHON	DREDA	DREDA GHON	DREDA	DREDA							
10400	BASRI	KADRI	BASHKIM BASRI	KADRI	KADRI							
2444	ARIF	TABAKU	BIKRIJE ARIF	GHOSHI ARIF	GHOSHI ARIF							
195	MIRIL	BUSHKORAJ	FRAN MIRE	BUSHKORAJ	BUSHKORAJ							
2803	RENJEP	LLOCI	BEKIM RENJEP	LLOCI	LLOCI							
4254	QEMAL	SUFKA	NETI QEMAL	SUFKA	SUFKA							
3722	SIRE	SHERU	SABIT SHERU	SHERU	SHERU							
2447	HAZIS	NOKA	HAMDI HAZIS	NOKA	NOKA							
42	MEHMET	HONHA	SHASHE MEHMET	HONHA	HONHA							
1514	ABDYLL	KEBELLUKU	ABDYLL KEBELLUKU	KEBELLUKU	KEBELLUKU							
3151	SHYQYRI	LACEJ	MALINDA SHYQYRI	HANBIRSHIA LACEJ	TAFIJA LACEJ							
1114	BEJVE	OMARI	AVLEFOJBE BEJVE	OMARI	OMARI							
10850	KOZMA	DADORLI	ILIANA KOZMA	STEFAN DADORLI	DADORLI							
3359	MUHARREM	FERKO	LEMAN MUHARREM	FERKO	FERKO							
7635	NIKOLLA	SKANA	LAVRA NIKOLLA	SKANA	SKANA							
287	TUNI	BARBE	TATIANA TUNI	BARBE	BARBE							
3344	RAMADAN	KADRRI	VERA RAMADAN	PIRJA	PIRJA							
2381	HAMIT	KRUP										
5325	GHETE	MARGJINI	MARIBE ZEF	MARGJINI	MARGJINI							
6522	SELMAN	BALLA	BEHARE SELMAN	MYZRI BALLA	MYZRI BALLA							
3254	FADIL	SOPOTI	GEZIM FADIL	SOPOTI	SOPOTI							
17194	SHERIF	LANGU	MUSHARRET SHERIF	LANGU	LANGU							
3255	Qemal	Vogli	Larje Qemal	Ramiz Vogli	Vogli							
34	QEMAL	XHELI	LULEJTA QEMAL	SAMI XHELI	XHELI							
5432	saadi	sharret	sharret saadi	saadi	saadi							
1168	SHALUDIN	XHANXHO	ARJEP SHALUDIN	REGA XHANXHO	XHANXHO							
5107	ANASTAS	NOTI	BERKIM ANASTAS	SHALUDIN NOTI	NOTI							
8755	GHIDO	XHEMITHRU	BERKIM GHIDO	XHEMITHRU	XHEMITHRU							
184	PETRO	SPIRU	JORGJI PETRO	SPIRU	SPIRU							
2575	ESTREF	PALLISHI	TASIM ESTREF	PALLISHI	PALLISHI							
4704	SHYQYRI	SULO	FITANEFIL SHYQYRI	SULO	SULO							
2693	SOTIRAKO	LAKO	DHIMITER SOTIRAKO	KOSTE LAKO	LAKO							
289	QENDRO	NIKDHIMA	LIBA QENDRO	MHO NIKDHIMA	NIKDHIMA							
10218	HAKI	QESIA	VALENTINA HAKI	QESIA	QESIA							
9072	HADJAR	FREGJAJ	JALILEZ HADJAR	BUKURJE HADJAR	FREGJAJ							

Eksperiencat e bibliotekares shqiptare në Worcester, përshtypjet për panairin

Rezarta Reso:

Si inkurajoj leximin në SHBA, më mungon të flas shqip

"Anglishtja nuk mjafton për të derdhur dashurinë që kam për librat"

Egla Xhemali

Të gjithë i mbajnë mend emisionet e fëmijëve që ajo drejtonte në TVSH e ngrohtësinë që u falte fëmijëve dhe publikut që e ndiqte përmes ekranit. Në këto ditë jubilar për ata që e duan librin e pikërisht në ditën e dytë të "Panairit të 21" patëm fatin të takonim Rezarta Reson. Pas shumë vitesh punë si bibliotekare në Amerikë, Reso kthehet për të marrë pjesë në panair pavarësisht se nuk është shkëputur asnjëherë nga Shqipëria përmes përkthimeve dhe librit të saj. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta shqiptare" Zonja Rezarta na zbulon metodat për t'i afruar fëmijët me librin, gabimet më të shpeshta që bëjnë prindërit në përzgjedhjet për të vegjlit e tyre, për punën që e bën me shumë pasion, si dhe për atë çka i mungon nga Shqipëria. Nga eksperiencat e saj Reso na tregon se gjithçka duhet të nisi që kur fëmija është në barkun e nënës, pra duhet lexuar me zë të lartë që kur nëna është shtatzënë. Ky proces vazhdon edhe kur ai është bebe dhe në të gjitha fazat e rritjes së tij. Kështu fëmija shndërrohet në lexues të zellshëm. Zonja Rezarta i mëshon fort bashkëpunimit që duhet të ketë prindi me fëmijën gjatë këtij procesi dhe se kurrsesi ata nuk duhet ta detyrojnë fëmijën të lexojë libra që nuk i pëlqejnë. Përkundrazi, prindërit duhet të jenë nxitje për të vegjlit duke i orientuar drejt librit.

Gjithë këto vite mes librash dhe po prap neqet një dashuri e patjetëruar nga pluhuri i kohës. Edhe në Amerikë ka mjaft problem sa i përket raportëve që kanë të rinjtë me librat megjithatë bibliotekarja ka shpresën se të gjithë së bashku mund të dalim për të ndriçuar sa më shumë fëmijët dhe të rinjtë drejt dritës. Asaj i mungon shqipja. Duket sikur fjalët në anglisht janë të pamjaftueshme për të shprehur se si rreh ajo pjesë e zemrës që i përket botës së mrekullive, letërsisë.

Cila është metoda më e mirë për t'i afruar fëmijët e veg-



Jël me librin?

Eksperiencia më ka mësuar që metoda më e mirë dhe më frytdhënëse për të afruar librin me fëmijët, është që fëmija duhet ekspozuar me librin sa më herët dhe me sa më shumë dashuri dhe pasion. Kur them sa më herët, nënkuptoj që libri i afrohet fëmijës që në barkun e nënës. Në bibliotekë punoj në departamentin e fëmijëve dhe të rinisë (Moshë 0-18 vjeç) dhe për pesë vjet kam drejtuar programin e nënave shtatzëna dhe atë të bebeve. Ju them me bindje të plotë që pas gati

20 vitesh punë në bibliotekë, ato nëna që sollën bebet e tyre që dyjavëshë apo dymuajshë në programet e bibliotekës dhe që u lexonin pa reshtur fëmijëve, kanë rritur lexues të zellshëm, që kanë qenë studentë të suksesshëm dhe që vazhdojnë ta duan dhe të mos e ndajnë librin nga dora. Një faktor tjetër; i njëjllotë për nga rëndësia më të parin, është ta inkurajosh fëmijën ta lexojë librin, sepse i ngjall kënaqësi dhe e mbështjell në një botë ëndërrash dhe imagjinatë frymëzuese. Leximi nuk duhet servirur si detyrë apo

si dënim, por si një mundësi përzgjedhesh për të eksploruar botën dhe për të njohur vetveten njëkohësisht.

Sa të interesuar janë ata që lexojnë?

Ata që lexojnë, janë ata që duan të lexojnë. Problemi qëndron se si të inkurajojmë lexuesit "dembelë" apo ata që nuk dinë të zgjedhin atë çka u pëlqen të lexojnë, ose mbase që nuk dinë as se dhe çfarë u pëlqen, sepse janë të ekspozuar shumë pak ose aspak ndaj librit.

Gabimet më të shpeshta që bëjnë prindërit në



përzgjedhjen e librave për fëmijë?

Unë jetoj që prej 24 vitesh në Amerikë dhe atje ka një lëvizje masive të bibliotekave dhe shkollave që prindërit t'i inkurajojnë fëmijët të lexojnë çdo gjë. Çdo lexim është i mirë, është eksperiençë që të mëson diçka. Sigurisht që ka rezistencë nga disa prindër dhe edukatorë që mendojnë se kontrolli për leximet e fëmijëve është i domosdoshëm, por ne përpigëmi të argumentojmë që përfitimi më i madh është kur prindi dhe fëmija diskutojnë bashkë atë çka fëmija ka lexuar duke parashtruar opinionet e prindit dhe jo duke ia mbyllur fëmijës shansin për të lexuar. Sidoqoftë, prindi mbetet në fuqi për të lejuar apo kundërshtuar llojin e leximeve për fëmijët, ne vetëm sugjerojmë atë çka mendojmë, gjë që është dhe e provar, që çdo lexim është i rëndësishëm.

Ju jeni një binom i pandarë me librat. Ku konsiston puna juaj?

Shumë e vërtetë, nuk mund ta imagjinoj veten time pa disa libra rrotull, që për arsye dhe të profesionit, i lexoj njëherësh. Siç ju thashë, puna si bibliotekare më ka lidhur pazgjidhshmërisht me bebet, nxënësit e shkollave dhe të rinjtë. Çdo pesë vjet ne qarkullojmë programet për grupmoshat e ndryshme dhe

ndërtojmë programet dhe aktivitetet në lidhje me moshën. Aktualisht unë jam koordinatore e lidhjeve të bibliotekave publike me shkollat nën moton se kur një nxënës nuk mund të vijë në bibliotekë, shkon biblioteka te nxënësi. Detyra ime është të inkurajoj leximin duke prezantuar botime të ndryshme, klasike apo bashkëkohore, të organizoj klubin e librit dhe atë të krijimeve letrare si dhe votimet e fëmijëve për librin me të mirë, që është "Çmimi i shtetit" që i jepet librit më të lexuar të votuar nga vetë fëmijët.

Me çfarë ritmesh lexohet në SHBA?

Si kudo, edhe në SHBA ka probleme të shumta që kanë të bëjnë me leximet e pakta, nivelin e dobët të leximeve apo konkurrimet që vijnë nga interneti dhe lojërat dixhitale. Detyra si edukatore dhe bibliotekare është që t'i joshim fëmijët me librin duke ua servirur me shumë dashuri dhe pasion, duke i inkurajuar me këmbëngulje dhe durim që çdo faqe e lexuar është një informacion që ju mëson diçka të re, të bukur dhe që mbetet gjithmonë me ju.

Jeni riktthyer përsëri në Shqipëri. Si ju duket atmosfera në këto ditë panairi?

Është panairi i parë ku marrë pjesë, meqenëse kam përkthyer një libër me kujtimet të tre autorëve amerikanë. "Në lojë



Aktorja shqiptare nuk përmbahet, do të kalojë një natë me Lorik Canën

Lorik Cana është kapiteni legjendar i Kombëtares shqiptare dhe ndër të parët futbollistë që ka e dërguar emrin e shqiptarëve lart në arenat europiane të futbollit. Përveç anës profesionale ku ai shkëlqen, pëlqehet nga shumë femra të showbizit dhe jo vetëm. Arjola Demiri e ftuar së fundmi në emisionin "Mirage" ku u bë pjesë e lojës "kë zgjedh", bukuroshja u vu përpara zgjedhjes midis emrave të njohur me të cilët ajo do të kishte dëshirë të kalonte një natë. Aktorja çuditi në emision kur zgjodhi Lorik Canën, në vend të Robert Berishës: "Fillova me u skuq nga kjo pyetje...Por, preferoj Lorik Canën".



'Ruaj burrin' Armina Mevlani merr paralajmërimin për Shkëlzenin nga Jul Deda

Armina Mevlani dhe Shkëlzen Berisha janë ndër çiftet më të komentuar të showbiz-it shqiptar. Bukuroshja është mjaft aktive në "Instagram", ku së fundmi ka postuar një foto të Shkëlzenit duke shkruar sipër "Omg" dhe duke e shoqëruar me emoji me sy me zemra. E njëjta foto u publikua edhe në profilin e Shkëlzenit, ku vijuan komentet mes dylesh dhe aktorit të humorit Jul Deda. Ishte ky fundit që i tregon Arminës të bëj kujdes: "Ruaj burrin!". Jul Deda mori dy përgjigje të ndryshme nga çifti, Shkëlzeni shkroi: "'Vreshtin' e ruan frika" dhe Armina "Kam teknikat e mia unë në ruajtje".



me Djallin", një libër, që përcjell jetën e një grupi shokësh të përfshirë në drogë dhe varësi të tjera shkatërruese, me pasoja tragjike dhe se si në një moment e kuptuan që po rrëzoheshin drejt një gremine vdekjeprurëse dhe u futën në rrugën e rikuperimit duke nisur një jetë nga e para dhe duke i dhënë shpresë dhe mbështetje me mijëra të rinjve që vuajnë këtë tragjedi. Në panair jam mrekulluar nga shumëllojshmëria e botimeve! Bleva disa libra dhe do të doja që të blija sa më shumë, të cilat do t'ia dhuroj bibliotekës ku punoj, sektorit të shqipes, pasi është e pamundur të blihen libra nga Shqipëria për arsye teknike dhe rregullave shpesh pa kuptim.

Unë kam bashkëpunuar për herë të parë me Dudajn për librin "Kujtimet e një Geishe", me Omra GVG për botimin e librit tim "Kur një burrë dashuron" dhe së fundi me shtëpinë botuese Dituria për librin "Në lojë me Djallin". I falënderoj për mundësinë që më kanë dhënë dhe shpresoj të vazhdoj kontributin tim modest në fushën e letërsisë, me përkthime apo shkrime të mia. **Mendoni se duhet të ketë më shumë përkthime apo prurje të letërsisë shqipe?** Personalisht i dua të dyja, por jo për hir të botimeve të ofrohen vepra apo përkthime të dobëta, të varfura, me nivele mediokre. Nuk mund ta inkurajojmë lexuesin pa e respektuar me vepra dinjitoze

dhe cilësore. **Çfarë ju mungon më shumë nga vendi juaj?** Pamundësia për t'u folur fëmijëve për librin në gjuhën time. Më mungon të flas shqip. Më duket sikur nuk më mjaftojnë fjalët në anglisht për të derdhur tërë dashurinë time për librat tek brezi i ri. **A kenë menduar të ktheheni?** I qasem këtij mendimi, por më duket i vështirë për sa kohë më duhet të punoj në Amerikë për të mbushur moshën e pensionit (që po afrohet pa u ndërë). Jeta ka plot të papritura dhe, ashtu siç nuk e kisha menduar kurë, në rini, që një ditë do jetoja në SHBA, mbase një shans tjetër mund të më kthejë në Shqipëri.

Nuk do ta besoni çfarë ka bërë fansi i Luanës për moderatoren

Luana Vjollca është një ndër moderatorët më seksi shqiptarë dhe shumë e dashur nga publiku. Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, duke ndarë shpesh me ndjekësit momente nga jeta e saj jashtë ekranit, por edhe momente profesionale. Shpesh herë na ka treguar që ka një marrëdhënie shumë të mirë me fansat e saj me të cilët bashkëbisedon shpesh në 'Instagram' dhe jo vetëm, e së fundmi është surprizuar nga një veprim i një prej fansave të saj. Njëri prej tyre ka prerë flokët dhe ka vizatuar fytyrën e moderatores dhe Luana nuk ka nguruar ta publikojë videon dhe krahas saj shkruan: "s'kam fjalë".



Ish-kryeministri i Maqedonisë u dënua me burg për shpërdorim detyre

Gruevski "i ikën burgut" në Shkup, me makinë diplomatike në Shqipëri

Mister hyrja, doli nga pika kufitare e Hanit të Hotit

Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski është arratisur nga vendi i tij duke kërkuar azil politik në Hungari. Ai ka kaluar transitin përmes Shqipërisë, duke udhëtuar me një makinë diplomatike të ambasadës hungareze në Tiranë. Ai mendohet të ketë hyrë ilegalisht në Shqipëri dhe ka dalë nga pika kufitare e Hanit të Hotit.

Me anë të një deklaratë për mediat, policia bën të ditur se shtetasi "Nikola Gruevski më datë 11.11.2018, rreth orës ora 19:11, ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikës së kalimit kufitar të Hanit të Hotit në drejtim të Malit të Zi, si pasagjer në automjetin me targë CD1013A, në pronësi të ambasadës hungareze në Tiranë".

Më tej në deklaratë "thuhet se në datën 11.11.2018 për shtetasin Nikola Gruevski nuk ka pasur asnjë njoftim në kufi apo shpallje si person në kërkim. Interpol Shkupi në datë 13.11.2018, rreth orës 19:35 i ka dërguar Interpol Tiranës njoftimin për shpallje në kërkim ndërkombëtar për këtë shtetas", mbyllet njoftimi i policisë.

Ndërkohë, në deklaratë nuk bëhet e ditur se kur dhe nga ku Gruevski është futur në vendin tonë.

REAGIMET DIPLOMATIKE

Pas kërkesës për azil të Gruevskit në Hungari kanë reaguar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Departamenti Amerikan i Shtetit beson se Nikola Gruevski, i cili ka kërkuar azil politik në Hungari, duhet të vuajë dënimin e tij me burg në vendin e tij. Kështu u shpreh një zyrtar i DASH. Nikolla Gruevski u dënua nga gjykata për keqpërdorim të detyrës zyrtare me vendim të plotfuqishëm me dy vjet burg. Përveç kësaj, Gruevski gjykohej për katër akuzat të tjera penale. "Ne konsiderojmë se procedurat gjyqësore në Maqedoni duhet të vazhdojnë dhe Nikolla Gruevski duhet të paraqitet para drejtësisë", tha përfaqësuesi i



Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski

Departamentit të Shtetit. Ndërsa Maqedonia i ka bërë burgun gati, ish-kryeministri Nikolla Gruevski është arratisur drejt Hungarisë, teksa ka kërkuar azil politik në Hungari. Mediat serbe shkruajnë se Gruevski ka kaluar kufirin maqedono-shqiptar me një pasaportë të rreme dhe ka arritur në mënyrë të paligjshme në Tiranë, ku është pranuar më pas në ambasadën hungareze. Një variant me nota të theksuara spekuluese jepet edhe nga gazeta serbe "Politika" për të ngatërruar edhe Tiranën në këtë histori. "Me anë të kompanisë 'Malev' ka fluturuar direkt nga Tirana në Budapest. Ekipu pashë i avionit nuk e ka ditur se kush është udhëtari me kapelë në kokë dhe syze dielli, të cilat nuk i ka hequr as në avion", shkruan e përditshmja serbe "Politika", edhe pse nëse do hulumtoje si duhej, do zbulonte se "Malev" ka pushtuar se funksionuar në Shqipëri prej disa vitesh. Lajmi i arratisjes së ish-kryeministrit ka zënë faqet e para të mediave të rajonit, por edhe më gjerë. Ndërkohë, opozita hungareze ka kërkuar me urgjencë dëbimin dhe largimin e ish-kryeministrit të Maqedonisë. Ndërkohë, mëso-

het se policia shqiptare është në dijeni të këtij fakti dhe autoritetet shqiptare po verifikojnë vërtetësinë e lajmit të mediave serbe. Ndërkohë, "News 24" pyeti pranë ambasadës hungareze lidhur me faktin nëse kishte informacione lidhur me këtë çështje. Por ambasada hungareze është përgjigjur se: "Nuk kemi koment për këtë çështje. Nuk komentojmë për çështje në proces e sipër". Ndërkohë, vetë qeveria hungareze ka reaguar lidhur me kërkesën e ish-kryeministrit maqedonas, Nikolla Gruevski, për të kërkuar azil politik në Hungari, pasi u shpall në kërkim ndërkombëtar. Përmes një reagimi publik, Hungaria thekson se

qeveria nuk e ka ndihmuar Gruevskin që të largohet nga Maqedonia. Nikolla Gruevski u largua nga vendi i tij për t'i shpëtuar dënimit të gjykatës me 2 vite burg për korrupsion. Kujtojmë se Maqedonia i ka bërë thirrje Hungarisë të ekstradojë Gruevskin, i cili ka qenë kryeministër nga 2006-2016. Pas shumë debateve dhe thashetheme, vetë ministri i Brendshëm, Oliver Spasovski ka thënë se familja e të arratisurit, Nikolla Gruevski është në Maqedoni. "Bashkëshortja e tij ka qenë në shtëpi dhe u ka mundësuar pjesëtarëve të MPB-së të kryejnë kontrollin. Kjo është bërë edhe në shtëpinë e nënës së tij", ka theksuar ministri

Spasovski në emisionin "Vetëm e vërteta" në "Kanal 5". Ndërkohë, partitë opozitare hungareze i kanë bërë thirrje qeverisë hungareze të arrestojë dhe sa më shpejt të ekstradojë ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, i cili ka kërkuar azil në Hungari. Partia nacionaliste hungareze "Jobbik" si dhe partitë e majta "Dialogu" dhe koalicionet demokratike, sot njoftuan se Gruevskit duhet t'i refuzohet azili dhe menjëherë të ekstradohet në Maqedoni, pasi drejtësia e vendit fqinj e ka dënuar me dy vite burg për shpërdorim dhe afere korruptive në dëm të interesit publik. Zëdhënës i "Jobbik", Adam Mircocki, e ka cilësuar rastin si "skandal të paparë", duke theksuar se Gruevski është "kriminel i kërkuar" nga një vend ku nuk ka luftë dhe se ai nuk është i përndjekur mbi baza fetare apo politike, raporton Alsat. Richard Barabash, zëdhënës i "Dialogut", theksoi se vendi i Gruevskit është "prapa grilave". Ndërkohë, ka ardhur edhe reagimi i policisë shqiptare lidhur me arratisjen e Gruevskit nga Shqipëria. Sipas policisë, Gruevski u paraqiti në doganën e Hanit të Hotit drejt Malit të Zi më 11 nëntor me makinën e ambasadës së Hungarisë në Tiranë. Por nuk sqarohet se kur dhe nga ka hyrë ish-kryeministri i Maqedonisë në vendin tonë. Nga komunikata zyrtare të Policisë së Shtetit del se Gruevski ka hyrë ilegalisht në territorin shqiptar.

Meta: Me largimin, Gruevski pranoi fajësinë

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta ka reaguar lidhur me arratisjen e ish-kryeministrit maqedonas, Nikolla Gruevski, drejt Hungarisë. Meta tha se, "largimi i tij është edhe një marrje e fajësisë". Në fundmi u zbulua se Gruevski ishte arratisur përmes Shqipërisë. "Çdo politikan, aq më tepër politikan me përgjegjësi të mëdha siç është rasti në fjalë, nuk duhet t'i shmanget as drejtësisë dhe as luftës politike. Nuk mund të gjykoj për çështjen në fjalë, se kemi të bëjmë me një vend tjetër dhe duke pasur këtë pozicion, nuk kam përse të hap një debat për këtë çështje. Por, ne kemi raste edhe në Shqipëri, kur ka pasur burgosje që janë konsideruar politike, janë përballuar. Largimi është edhe një marrje e fajësisë së tij, pavarësisht nga pretendimet që mund të paraqesë", deklaroi Meta.

Kryeministria serbe: S'jemi gati për anëtarësimin në BE

Ana Brnabić, për marrëdhëniet me Kosovën: Deri në vitin 2025 do të arrijmë një akord

Kryeministria e Serbisë, Ana Brnabić në një intervistë për "Deutsche Welle" ka folur për rrugën e anëtarësimit të Serbisë në BE si dhe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Tim Sebastian (DW): Një prej kushteve që Serbia të anëtarësohet në Bashkimin Evropian është normalizimi i obligueshëm i raporteve me Kosovën, që ju nuk e njihni. Negociatat po vazhdojnë, por ndonjëherë edhe po ndërpriten. Pse BE duhet të merret me këto grindje? A nuk jeni ju një problem tepër i madh për BE?

Ana Brnabić: Mendoj se sa është i madh interesi ynë

ANA BRNABIĆ

Mendoj se sa është i madh interesi ynë që t'i bashkohemi BE-së, aq i madh është edhe interesi i BE për zgjerim në Ballkan. BE është në radhë të parë një projekt paqësor dhe i suksesshëm, sepse për herë të parë në Evropë kemi një paqe afatgjatë.

që t'i bashkohemi BE-së, aq i madh është edhe interesi i BE për zgjerim në Ballkan. BE është në radhë të parë një projekt paqësor dhe i suksesshëm, sepse për herë të parë në Evropë kemi një paqe afatgjatë.

TS: Mirë ky është mendimi juaj, por BE ka thënë qartë se nuk do të importojë probleme të reja bilaterale. Jean Claude Juncker e ka thënë këtë vitin e kaluar. Kjo është e qartë apo jo?
AB: Po e qartë është.
TS: Pra nuk do ta importojë problemin tuaj me Kosovën.
AB: Kjo është absolutisht e

qartë...
TS: Nëse nuk e zgjidhni këtë problem, nuk do të futeni në BE, apo jo?
AB: ...kjo është për mua normale. Mendoj se kjo është në natyrën e punës. Sikur të isha BE edhe unë do të kërkoja të njëjtin gjë.
TS: Por ju nuk do të bibi akord shpejt, këtë e keni pranuar vetë. Pra, nuk do të keni ndonjë perspektivë të futjes në BE, në një të ardhme të shpejtë?
AB: Këtu nuk pajtohem tërësisht me ju, sepse termini më i afërt i anëtarësimit të mundshëm në BE për ne është viti 2025. Ndaj mendoj se



Kryeministria e Serbisë, Ana Brnabić

ekziston mundësia që deri në vitin 2025 të nënshkruajmë një marrëveshje të qëndrueshme për normalizimin e raporteve me Prishtinën.
TS: Por në këtë moment, nuk duken gjërat këshu. AB: Nuk e them se kjo do të ndodhë. Them se Serbia është e përkushtuar për

këtë. Kjo nuk varet vetëm nga Serbia, varet edhe nga Prishtina dhe aleatët tanë. Ndaj mendoj se ne po shkojmë drejt BE-së. Për mua është me rëndësi që t'i implementojmë të gjitha reformat, me qëllim që shoqëria jonë të jetë politikisht dhe ekonomikisht e pjekur për BE.

Britani, 5 ministra largohen në protestë ndaj paktit me BE-në

Sekretari britanik i Brexit jep dorëheqjen: S'ma lejon ndërgjegjia

Theresa May: Na presin ditë të vështira

Ditën e djeshme, sekretari i Brexit, Dominic Raab, dha dorëheqjen duke thënë se "ndërgjegjia nuk ia lejon që të mbështesë projekt-marrëveshjen e Brexit nga ana e Britanisë". Theresa May njoftoi mbrëmjen e të mërkurës se kishte siguruar mbështetjen e kabinetit të saj për marrëveshjen, pas një takimi që zgjati 5 orë. Megjithatë, disa ministra ishin kundër kësaj marrëveshjeje, shkruan 'BBC'. Dhe ende ka hipoteza për një lëvizje midis mbështetësve konservatorë për të detyruar një votë mosbesimi për të. Kryeministria pritet të bëjë një deklaratë mbi marrëveshjen e Brexit. Raab, një mbështetës i lëvizjes, i cili u promovua në kabinet për të zëvendësuar David Davis, kur u largua në shenjë proteste ndaj planeve të May për Brexit, është në mesin e një grupi ministrash të lartë, që mendohet se janë të pakënaqur me marrëveshjen. "Na presin ditë të vështira", tha kryeministria britanike Theresa May në Londër, kur deklaroi se kishte siguruar mbështetjen e kabinetit të saj qeveritar për një marrëveshje të vështirë "divorci" me Bashkimin Evropian, pas një mbledhjeje të nxehtë dhe shpesh me tensione, që zgjati pesë orë. Shumë shpejt këto fjalë u dukën sikur ishin të buta për të reflektuar rrjedhën e mëpasshme të ngjarjeve. Pak pasi zonja May foli, ministri i saj për Brexit, Dominic Raab, që ndihmoi për hartimin e marrëveshjes dhe dorëheqjen në shenjë proteste, duke thënë se nuk mundet t'i mbështeste "me ndërgjegje të pastër" kush-



Sekretari i Brexit, Dominic Raab

ten e paktit. Përkrahësit e vendosur të daljes nga BE-ja argumentojnë se ai e vë Britaninë në një pozitë inferiore ndaj Bashkimit Evropian dhe se vendi nuk do të mund të dilte prej marrëveshjes pa miratimin e Brukselit. Një ministër tjetër dhe dorëheqjen para zotit Raab dhe tre ministra të tjerë e pasuan, ndërsa mbështetësit e Brexit-it po bënin përpjekje të hapura për ta rrëzuar zonjën May si udhëheqëse konservatore, duke e dobësuar në mënyrë të konsiderueshme autoritetin e saj. Tani, e ardhmja e një marrëveshjeje për të cilën u deshën një vit negociata dhe fati i vetë qeverisë konservatore është në dyshim. Po ashtu, po shtrohen pyetje për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme, të cilat mund të fito-

hen nga Partia Laburiste, apo për mbajtjen e një referendumi të dytë për Brexit-in, që mund të përmbyste votimin e mëparshëm për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian. Një tjetër mundësi është që me afrimin e afatit për daljen zyrtare nga BE-ja pas 134 ditësh, Britania mund të detyrohet të dalë nga blloku pa një marrëveshje, një rezultat që analistët dhe udhëheqësit e biznesit thonë se do ta fuste në kaos ekonominë e Britanisë. Para Dhomës së Komuneve të enjten, zonja May u përball me sulme të ashpra nga anëtarët e partisë së vet, që pretendojnë se marrëveshja është një "traktat nënshtrimi", si edhe nga ligjvënësit e opozitës. Ajo këmbënguli se marrëveshja është më e mira që mund të siguronte

Britania. Projekt-marrëveshja me BE-në parashikon që Britania të mbetet në një bashkim doganash për disa vjet me BE-në, pas daljes nga blloku, por pa një rrugë të qartë ligjore për daljen nga pakti për doganat, ndërsa negociohet një marrëveshje tregtare, kushtet e së cilës deri tani janë të paqarta, shkruan VOA. Zonja May tha në sallën e mbushur plot të Dhomës së Komuneve, që herë-herë ishte e zymtë dhe herë-herë e zhurmshme se po vepron në favor të interesit kombëtar dhe se "projekt-traktati do të garantonte që të dalim nga BE-ja në një mënyrë të qetë dhe të rregullt". Komenti i saj u prit me të qeshura. Kryeministria këmbënguli: "Zgjedhja është e qartë. Mund të vendosim të dalim

pa një marrëveshje, apo të rrezikojmë të mos kemi Brexit. Ose mund të zgjedhim të bashkoheni dhe të mbështesim marrëveshjen më të mirë të mundshme". Jeremy Corbyn, udhëheqësi i Partisë Laburiste në opozitë tha se zonja May po ofronte "një zgjedhje të rreme mes mungesës së një marrëveshjeje dhe kësaj marrëveshjeje", për të cilën ai tha se "përfaqëson një dështim të jashtëzakonshëm dhe të dëmshëm". Por, kryeministria duket e vendosur të vazhdojë të rrugën e saj. Disa ligjvënës konservatorë euro-skeptikë, njoftohet se kanë dorëzuar letra tek udhëheqësit e partisë në parlament duke kërkuar një votëbesim për udhëheqjen e saj, duke thënë se ka ardhur koha për ndryshim.

Theresa May

"Zgjedhja është e qartë. Mund të vendosim të dalim pa një marrëveshje, apo të rrezikojmë të mos kemi Brexit. Ose mund të zgjedhim të bashkoheni dhe të mbështesim marrëveshjen më të mirë të mundshme".

SHKURT

Pritet një takim i dytë Trump-Kim Jong vitin e ardhshëm

Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, mund të takohet me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong, në vitin 2019, por nuk do të përsërisë gabimet e së kaluarës për të lejuar shkeljen e premtimeve për t'i dhënë fund programit të armëve kimike", tha sot nënpresidenti amerikan, Mike Pence. SHBA-të dhe Koreja e Veriut janë në bisedime për datën në të cilën udhëheqësit e dy shteteve do të kenë takimin e tyre të dytë, pasi i pari në Singapor, i mbajtur në qershor, ishte për hedhjen e bazave për t'i dhënë fund konfliktit mes dy vendeve mbi programin e armëve bërthamore të Koresë së Veriut. Një qendër studimi amerikane njoftoi të hënën se ka identifikuar të paktën 13 nga 20 bazat aktive me raketa, të padëklaruar nga Koreja e Veriut, duke rritur sfidën me të cilën po përballen negociatorët amerikanë që kërkojnë të bindin Kim të braktisë programet e tij të armatimit.

Përplasen 2 autobusë shkolle në Gjermani, 40 të plagosur

Rreth 40 persona, shuëmica fëmijë, u plagosën djeh në një përplasje mes dy autobusësh në rajonin gjerman të Bavarisë, njoftoi policia lokale. "Mes të plagosurve, të paktën pesë janë në gjendje të rëndë", theksoi një zëdhënësi i policisë, shkruan ATSH. Arsyeja e përplasjes ende nuk njihet, shtuan të njëjtat burime. Të plagosurit në gjendje të rëndë u dërguan me helikopter në spital.

Japoni, shokon ministri: Skam përdorur kurrë një kompjuter

Ministri japonez përgjegjës për sigurinë informatike ka pranuar që nuk ka përdorur asnjëherë në jetën e tij një kompjuter dhe që nuk e di se çfarë është një USB-ja. Gjatë një seance parlamentare Yoshitaka Sakurada, 68 vjeç, që mbulon edhe ministrinë e Lojërave Olimpikë "Tokio 2020" pranoi se që prej moshës 25 vjeç, gjithmonë është ndihmuar nga punonjësit e tij apo sekretarët dhe kurrë s'ka përdorur një kompjuter. Pyetjes së bërë nga opozita se si mundet një funksionar të parandalojë hakerimet për Lojërat Olimpikë nëse vetë drejtohet nuk di të përdor një PC, Sakurada i është përgjigjur që e gjithë makina qeveritare dhe zyra e tij arrijnë të menaxhojnë situatën siç duhet. Ai gjithashtu u tregua si i përnumbur teksa e pyetën nëse çelësat USB ishin përdorur në centratel bërthamore.

KALIFORNI, 58 TË VDEKUR DHE 300 TË ZHDUKUR NGA ZJARRET

Shkon në 58 bilanci i viktimave nga zjarret shkatërruese në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe më shumë se 300 të zhdukur. Një burim i katërt zjarri po avancojnë në jug, duke iu bashkuar tre zjarreve që kanë shkatërruar plotësisht zonën në veri të kryeqytetit Sacramento, Los Angeles dhe Malibu.



FOTOLAJM

Kokaina në Ekuador, kush është shqiptari kreu i organizatës

11 persona janë arrestuar pas operacionit ndërkombehtar antidrogë, që u shtri në Ekuador dhe Greqi. Në sajë të këtij operacioni janë arrestuar 8 shtetas në Ekuador dhe 3 në Greqi, mes të cilëve edhe një shqiptar, që konsiderohet si kreu i organizatës bashkë me dy grekë. Mësohet se shqiptari i arrestuar në Greqi është Ilia Petro Papa dhe ka lindur më 04.12.1977 në Elbasan, ndërsa banon në Kolargou të Athinës. Shqiptari rezultoi person me precedentë penalë, pasi më herët ai është arrestuar në Itali për trafikim të 200 kg marijuanë. Operacioni është zhvilluar mbrëmjen e 13 nëntorit dhe orët e para të datës 14. Nga aksioni janë sekuestruar rreth 300 kg kokainë me destinacion Australinë. Thuhet se aty do të shkarkohej pjesa më e madhe e drogës dhe pjesa tjetër do të shkonte në Greqi. Ndërkohë, mediat greke raportojnë se kokaina e sekuestruar gjatë operacionit ndërkombehtar në Ekuador ishte porositur nga mafia shqiptare.

PANAIRI

KRYEEMRAT E "SCANDERBEG"

Aty ku bashkohen Franzen e

Murakami me Ačkën e Pamukun

Fatmira Nikolli

Tani kemi zbritur në perandorinë e pranimit, ku portat janë të ngushta, dhe ne, shndërruar në ajër, hyjmë, të prekim kudo, në shpirtin tënd, në pafundësi, ku pafundësia, për herë të parë na është kufizuar, nga etërnia e mungesës, që po ndërtohet, ngadalë, pa trajtë, si anebë makabre, në shpirtat tanë, që të duan, që të deshën, e do të t'duan pafund, dhe do të ndalin këtyre brigjeve, këtij planeti ngjyrëuji, të flasin sy më sy, me ty".

Është kjo një prej poezive të Flutura Ačkës nga vëllimi i fundit. Nën titullin "Roja e dritës", shkrimtarja e njohur gjen fletët e bardha si "terapinë" e një jete pa të birin, që e humbi para kohe disa muaj më parë. Mes rreshtave, disa prej tyre të shkruar nëpër spitale, në orët e pritjeve të gjata që jepnin shpresa, ajo rrefen nënën, rrefen gruan dhe dhimbjen që bartin të dyja, kur shohin një dritë të bardhë të bukur të shuhet. Në stendën e "Scanderbeg books" ajo është e ulur si çdo vit, duke ruajtur jo vetëm imazhin e një botueseje që përzgjedh, por edhe Fluturën që qëndron në këmbë, pavarësisht se si. Mes titujve të rinj të panairit, ajo ka disa kryeemra që po i shënojmë më poshtë, me bindjen se janë mes më të mirëve që ekzistojnë.

HARUKI MURAKAMI

"Murakami, mbase na merr thellë e më thellë në një modernitet të thyer dhe mes banorëve të tij të paqetë, por ai kujdeset për zemrat dhe mendjet, mu ashtu, që ata të ndjehen dhe të shohin shpirtin rezistent dhe të paepur të njerëzimit", ka shkruar "The Washington Post", "I pangjyri Tzukuru Tazaki dhe vitet e tij të pelegrinazhit", romani i Haruki Murakami përkthyer nga Artan Kuçi sjell historinë e pesë shokëve të ngushtë në Nagoja. Katër prej tyre, dy vajza dhe dy djem, kishin në emrat e tyre të përfshirë nga një ngjyrë: të kuqe, blu, të zezë dhe të bardhë. I vetmi, ai i pesti, Tsukuru Tazaki, më i flashkëti prej tyre, më i tërhequri dhe më i pasigurti, i mbetet të quej "I pangjyri". Këtë lidhje të fortë mes tyre, ata prirën ta mbajnë edhe pasi Tsukuru shkon për studime në Tokio, i joshur nga pasioni i tij i përgjeshëm për stacionet e trenave, ku shpesh ulet për të ndjekur dhe këqyruar me orë, valën e njerëzve që lëvizin të shkuajdesur ndaj pasionit të tij. Por kuinteti laryshan do të prishet shpejt dhe Tsukuru, tashmë një inxhinier stacionesh hekurudhore, do të mbesë në një stacion të çuditshëm të miqësisë së tij të shenjtë, të tillë që nuk mund as ta imagjinojë, as ta projektojë apo ta



zgjidhë këtë enigmë të tij: braktisjen nga miqtë e tij të dikurshëm. Me ndihmën e miqve të rinj, ai do të nisët në kërkim të tyre dhe do të përballet me të papritura të çuditshme, të tilla që vetëm në vepra si të Haruki Murakami gjen dhe të tilla që asnjë lloj fantazie jona nuk mund t'i parashikojë. Muzika, ngjyrrat, përshkrimi surrealist, pasione çmendurake, ikje pa destinacion dhe të gjitha shenjat magjepsëse të botës së Murakami, që lexuesi shqiptar i njeh prej vitesh, vijnë sërish edhe më fuqishëm në këtë kryevepër të magjisë, rrëfimit dhe peizazhit mjeshteror letrar.

ORHAN PAMUK

Orhan Pamuk flet shqip me "Xhevetet beu dhe të bijtë", ose atë që njihet si kronika e tij familjare. Romani i përkthyer nga Stefan Vuçani është vepra e parë që autori

Nga rrëfimi i një nëne, te Stambolli kur themelohej republika e Tokio magjepsëse



nobelist, Orhan Pamuk, shkroi. Ishte viti 1979 e kur shkruante këtë veper, Turqia po kalonte një nga turbullirat më të ashpër politike të historisë së saj; ishin ditët e vrullshme para grushtit të shtetit, përvoja e hidhur e të cilit e përshkon këtë libër. Rrëfimi fillon me rënie e Perandorisë Osmane dhe pasojat e saj, dhe jep një imazh të mrekullueshëm të Stambollit dhe të banorëve të tij për një shekull të tërë. Është Xheveti, një prej tregtarëve të parë myslimanë, ai që na përgatit për një botë të tërë imazhesh dhe ndodhish si dhe këtë ortek marramendës idesh dhe kronikash. Ai po bëhet gati që të martohet, ëndërron të zgjerojë biznesin e tij dhe të bëjë

pasuri, të krijojë një familje të madhe, madje një familje moderne stambolli me shembëlltërinë e jetës përëndimore, ndikim që ka nisur të ndjehet tashmë nëpër ajër. Tregtari ynë ia del të mbledhë kapital dhe të bëhet një qytetar i ri i botës në këtë Republikë të re turke. Me përvojat dhe jetën e pasur të Xhevetit, të të bijve dhe të nipërve të tij, Pamuk na jep historinë e modernizimit të Turqisë së shekullit të 20-të. "Unë rrija në dritaren time, ndërkohë që miqtë e mi përballëshin jashtë me terrorin. Ndjehesha fajtor që në ato ditë kur qëmtoja për këtë libër, miqtë e mi arratiseshin nga vendi ose futeshin nëpër burgje", shkruan Pa-

muk për ditët kur e formësonte këtë veper, ky prag i parë nga nisja e tij e gjatë prej rrëfimitari të madh. **JONATHAN FRANZEN**

"Purity" e Jonathan Franzen, romani i përkthyer nga Artan Qoqi nis me një vajzë e re në krye të të njëzetave të saj, që punon si shitëse telefonash dhe po përpigjet fort që të paguajë kredinë e majme që ka marrë për të kryer studimet e saj universitare. Ka përplasje të shpeshta me të ëmën, Penelopën, e cila ia mban larg së bijës së shkuarën prej fëmije, madje edhe vetë identitetin, me gjithë këmbënguljen e Pipit për të njohur babain e saj natyral. Në Oklend, në qytetin ku jeton dhe në mjedisin ku gjendet, Pipi do të ndeshë një botë të tërë ngjarjesh politike e sociale dhe jetësh ndërzoze, një shtjellë të gjithfarë ndodhish, që do të lënë shenja në jetën e saj dhe pjesë e së cilës do të bëhet, jo si një vajzë pasive dhe e shkuajdesur, por si e pranishme dhe aktore e kësaj historie të gjatë dhe të pasur, që përtej një rrëfimi të thjeshtë artistik, është edhe një skaner i të vërtetave historike të shekullit që po jetojmë.

Autori i mirënjohur amerikan, Jonathan Franzen, pas romaneve të mrekullueshëm "Korrigjimet" dhe "Liria", vjen në shqip me një tjetër sagë të qytetërimit të sotëm, një libër që mezi pret ta mbarosh. I cilësuar nga kritika si një nga rrëfimet më brilant të kohës sonë, ai na fton në një magji rrugëtimi artistik, dhe për lexuesin e tij që tashmë e njeh shqip, ky libër është një prag i ri për në botën e pasur dhe të shqetësuar të këtij autori të mrekullueshëm.

KUMBARO BRAKTIS PARLAMENTIN PËR "SFIDAT E LEXIMIT", PETRIT YMERI: BIBLIOTEKAT JANË BOSH

Bibliotekat janë bosh! Ka qenë ky alarmi që dha dje kreu i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, Petrit Ymeri, në konferencën e mbajtur lidhur me "Sfidat e leximit sot! Çfarë lexojnë të rinjtë në Shqipëri?". Në një panel diskutimi me botues, shkrimtarë, përfaqësues të institucioneve të kulturës dhe arsimi, mësues, punonjës të bibliotekave, përkthyes etj., mori pjesë edhe Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro për të shkëmbyer mendime rreth promovimit të leximit dhe edukimit të lexuesve, fëmijë dhe të rinj. Duke falënderuar Ministrën e Kulturës, Mirela Kumbaro, që ju bashkua takimit, Z. Ymeri tha: "Po të vësh re bibliotekat e shkollave sidomos, përballësh me një situatë jo të gëzuar. Mendoj

që është e domosdoshme që të bëhen ndryshime rrënjësore. Është edhe një problem të cilit Ministria e Kulturës i ka kushtuar vëmendje, sidomos muajve të fundit, me projekte të ndryshme si "Takohemi për një libër". Kemi bërë një tur me një grup të Shoqatës së Botuesve vjet në disa qytete të jugut të Shqipërisë, në shkolla të qyteteve dhe fshatrave dhe ishte një trishtim i vërtetë". Sipas Ymerit, duhet një lëvizje dhe një bashkëpunim shumë i mirë për të pasuruar bibliotekat. "Në fund të fundit është detyrë e të gjithëve, por është detyrë e shtetit në radhë të parë që të ushtrojë një detyrim kushtetues për t'i dhënë kulturë



rinisë, fëmijëve. Duhet të kemi ide të qarta, duhen buxhete, dhe duhet organizim, një bashkëpunim", theksoi ai. Ndërsa ministria Kumbaro, me të mbërritur nga e enjta parlamentare në sallën ovale të Pallatit të Kongreseve ku mbahet Panairi i Librit, vërejtji se la parla-

mentin për librin, sepse për të sfida e leximit ka më tepër rëndësi. "Kemi katër vjet që e vëmë theksin të leximi dhe lexuesi, kur flasim për librin. U referohemi disa shifra të cilat dolën nga INSTAT, por që nuk janë befasisëse edhe pse tronditëse. Këto shifra nuk u shoqëruan me një analizë më tej, që nuk është vetëm Ministria e Kulturës apo Shoqata e Botuesve, që duhet ta bëjë, por leximi si një mënyrë, si një instrument, si një rrugë emancipimi i shoqërisë duhet të jetë një çështje që shoqëron të gjithë aktorët shtetërorë, publik, privat por edhe ata social", u shpreh Kumbaro.

INTERVISTA

Fatmira Nikolli

NOELLE BARKSHIRE:

Disa nëna derdhin lot edhe në orët e ndritshme të historisë

Shkrimtarja greke në Tiranë prezanton romanin "Nga lisi plak dhe shkëmbi"

Pata rastin që ta studioj nga afër, brenda shtëpisë sime. Historia bën cikle, i pëlqejnë edhe lojërat, dhe kjo e vërtetë shumë pak na lehtëson, sepse na thotë në sy ajo që po ndodh sot, ka ndodhur përsëri dhe do të ndodhë prapë në të ardhmen. Është elementi i historisë që më pëlqen më pak. Sepse edhe në rastet e fitoreve, gjatë orëve të shndritshme të Historisë, disa nëna derdhin lot.

Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", shkrimtarja greke Noelle Barkshire, autore e romanit "Nga lisi plak dhe shkëmbi" ndalet të raportojë ynë me veten, me historinë dhe me të shkuarën tonë. Duke nisur nga familja e saj, koha që e shihte të atin të shuhej, Noelle rrefëhet për librat e saj dhe pikënisjet e tyre, nga çfarë i ndan në çfarë i bashkon. Romani, i përkthyer nga Kristo Pulla, botuar nga "Toena", është i pari i saj në shqip.

- Është hera e parë që vizitoni Shqipërinë?

Po, është hera e parë dhe jam e gëzuar që po vij këtu për këtë rast fatlum.

- Romani "Nga lisi plak dhe shkëmbi" është romani i parë i sjellë në shqip. Ç'botim do të donit në shqip po këtëj?

Mbase kur të vinte momenti për një libër të dytë timin, mund të përzgjidhej "Duke ndjekur vijën e detit" ngase i referohet gjerësisht Erik Shlimanit, personazhet gjerësisht i njohur dhe interesant. Përmend këtë titull sepse është si një guidë çlodhëse në Peloponëzin e bukur dhe sepse në këtë libër rol kryesor luan deti, që lidh të gjitha vendet dhe popujt që lagen për tij. Deti shërben si një kufi i përbashkët, që nuk ndan, përkundrazi, i bashkon njerëzit. Mbase do thosha librin "Natën që u ndërruan vitet", që megjithëse historik, trajton pamounësinë e kohëve moderne, që për fat të keq përbën një realitet të përbotshtëm. Tani e kuptoni besoj se përse shkrimtari nuk mund të thotë fjalën e tij në marrjen e këtij vendimi.

- Burrat në roman duket sikur vetëm veprojnë, përse nuk keni depërtuar në thellë në psikologjinë e tyre?

Libri nis me një rrefim në vetën e parë të një gruaje, prej kur ishte vajzë e vogël. Heroina e sjell botën ashtu siç e shikonte në atë kohë. Më pas, rolin kryesor e kanë përsëri gratë, ajo vetë dhe të bijat, duke vijuar rrefimin në vetën e parë. Është e kuptueshme që për burrat, për ndjenjat dhe emocionet e tyre, ndërkohë që marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë dinamike në shtjellimin e ngjarjeve, përkrahimi na jepet nëpërmjet grave të familjeve të tyre, ashtu siç i shohin dhe i perceptojnë ato. Kalon nëpër filtrin e personalitetit të tyre. Aty ku mungon kjo marrëdhënie, si në historinë e Paraskevait, aty personazhi-burrë rrefen vetë për veten e vet dhe humltoni i karakterit të tij ndjek metodën klasike. Herëherë, libri përmban elementë nga

historia e familjes sime, të cilën e kanë shkruar kryesisht burrat e familjes. Synimi ishte që kujtimet nostalgjike të mos më merrnin me vete. Përjashtimi i vetëm që bëra ishte shfaqja e dashurisë së Paraskevait për të bijën që kishte humbur, kur më në fund ai e gjeti. Për ato faqe si dhe për vargjet e këngëve që i kushtonte, u nisa nga gjendja në të cilën ndodhej im atë atëherë, që prej sëmundjes, po humbiste të bijën, mua. E dinte që do të ishte nga kjo jetë. Më tregonte se më shumë i vinte keq ngaqë do të na humbiste ne. Shprehjen e fytyrës së tim atë, që po e ndiqja teksa lexonte vargjet e Paraskevait, nuk do ta harroj kurrë! Dua të them se tek "Lisi" im ka një ndjesi kolosale e nëndheshme edhe për personazhet burra, është një lumë i nëndheshëm.

- Igjithë romani ka nuanca pozitive. A deshët që lexuesit të merrnin vetëm ndjesi të mira?

Këto nota, u përdorën vetëm për një qëllim: për të lehtësuar lexuesin. Për fat të keq, shekulli i 20-të nuk ishte një shekull i gëzueshëm për botën. Është i mbushur me ngjarje dramatike. Rrefimi në libër ndjek ulje-ngritjet e dramacitetit që përvihoi historinë. Ka skena ku drama arrin kulmet e veta. Gjykova që pas kësaj, lexuesit i duhej një pushim. Kam përdorur edhe pasazhe nga "Odiseja" e Homerit. Lexuesi i kënaqet, dhe shkon në një vend tjetër. Diku është përshkrimi disi i zgjeruar i një peizazhi për shembull, që i jep lexuesit kohën e duhur për të "marrë frymë". Nga pikëpamja e teknikës së të shkruarit, pjesa më e përshtatshme për një interludio optimiste, është ajo kur vërtetohet e kundërtja e tij. Në jetë ekzistojnë gjithandë kontrastet e skajshme, por që bashkekzistojnë, si psh. drita-errësira, gëzimi- hidhërimi etj. Ndaj, krahas ecurisë pozitive të personazheve, ofroja edhe "porta shpëtimi", por edhe vendqëndrimet meditative.

- Përse pikërisht Homerit dhe elementet e veprës së tij "Odiseja"?

Sepse Homeri dhe vepra e tij kishin mbërritur ndërkohë nëpërmjet kanaleve të ndërvaresisë. Gjatë kohës që po shtjelloja idenë e veprës, një fazë që i para-prin shkrimit, vura re se sa shumë prej atyre që ne i quajmë vlera primitive, ndërthureshin në të. Dashedur ia nostalgjia për atdheun, familja, dashuria e nënës, dashuria dhe përkushtimi për shokun... Si të qe e shkruar, më erdhi ndërmend Penelopa homerike nga "Odiseja".



Noelle Barkshire

U impresionova nga mënyra e natyrshme më të cilën heroina e librit tim, i ishte afruar atij modeli gruaje të lashtësisë. Thua se midis Penelopës homerike dhe asaj të librit tim, kishin ndërmjetësuar me mijëra Penelopa me po ato karakteristika. Dhe për t'ia treguar këtë edhe lexuesit, fillova që të lançoj në mënyrë përzgjedhëse episode dhe skena të Penelopës së "Odiseës" në librin "Nga lisi plak dhe shkëmbi". Madje në caste kulmore, Penelopa e shekullit të 20-të flet në gjuhën homerike. Ato caste i takojnë së kaluarës së përbashkët të të gjitha grave.

- Të rreqh edhe mënyra e të shkruarit, "Finesa e fjalës", thjeshtësia e rrefimit. Ky është stili juaj i të shkruarit, apo është karakteristik vetëm në romanin "Nga lisi plak dhe shkëmbi"?

Vetë shekulli i 20-të ishte i rëndë, ndaj mënyra e të shkruarit të librit duhej të mos e bënte akoma më të rëndë atmosferën. Por as melodramaciteti nuk i shkonte, sepse njerëzit që e jetuan atë, ishin krenarë. Finesa e fjalës për të cilën më pyesni, është pikërisht kjo gjë: fisnikëria. Ndieja sikur njerëz dhe ngjarje po më ftonin që t'i lija të lirë të luanin rolin e protagonistit.



Këtë rrjedh edhe thjeshtësia e të rrefyerit. Ndërhyrjet e copëzave me karakter lirik që i ngjajnë një përroi emocional, shtensiononin nevojën që të çliroheshia prej ngarkesave emocionale gjatë shkrimit të librit. Ato funksiononin si një qetësues, si një pushim që më duhej ta bëja patjetër. U shërbyen me të njëjtën mënyrë edhe lexuesve, sepse secili prej tyre, në kontakt me to, u çlirua prej asaj ngarkese emocionale. Mënyra e të shkruarit të shkrimtarëve me kalimin e kohës bëhet e dallueshme, ashtu siç ndodh me mënyrën e të ecurit, kur njeriu duke dëgjuar hapat nëpër shkallë, dallon ato të njëjtin të vet nga ato të fqinjit. Në çdo libër, mënyra e shkrimit, merr formën e shtjellimit të temës dhe i mbështjell personazhet, si një letër e butë ambalazhi. Në librin "Duke ndjekur linjën e detit", ka kapituj që ndjekim të ashtuquajturin "realizëm magjik". Ndërsa te libri "Natën që u ndërruan vitet" ndërthuren në një tri kohë të ndryshme (e kaluara, epoka moderne dhe momentet e leximit).

- Si janë pritur veprat tuaja nga grekët që ndihen krenar për letërsinë antike?

Nëse i referoheni romanit "Nga lisi plak dhe shkëmbi", që prej momentit që doli në qarkullim u fut në listën e librave më të shitur dhe mbeti aty për shumë javë. Për shumë kohë ishte ndër 10 librat më të mirë, edhe sot është një libër me një ecuri të mirë dhe të qëndrueshme. Kritika e cilësoi si librin që drejtoi letërsinë që i referohet luftës së Azisë së Vogël. Mandej, në çdo vend ka edhe një të kaluar, që ia vlen që ta mbajë mend, njerëzve u duhet që të shkelin dhe të mbështeten diku. Kërkojnë një terren normal. Krijimtaria e lashë greke na ofron një terren me karakteristika të tilla. Me lluminizmin dhe Filohelenizmin Europian, Greqia e kohëve të reja erdhi në kontakt me atë çka krijoi kjo tokë në lashtësi. Them se administrimi i krenarisë është më përcaktues se edhe vetë krenaria.

- Itinerari i Penelopës: Turqi, Qipro, përsëri Turqi dhe Qipro e mandej Indi për shkak të luftës dhe më në fund në Greqi, ngjason pak me zhvillimet e sotme dhe flukset migratore nga rajonet në luftë. Ne këtë vështrim, do të jetë romani juaj një ngushëllim dhe një shpresë se më në fund dhe për këta njerëz do të ketë një Itakë?

Duke njohur historinë, jam plotësisht e bindur se ata do të arrijnë në Itakën e tyre dhe se jeta e tyre nuk do të vazhdojë kështu për gjithmonë. Këtë e them dhe në librin im. Çdo njeri përjeton rrugëtimin drejt Itakës së vet personale. Por kur të arrijë aty, nuk do të jetë ai i mëparshmi, dhe kurrë nuk do të bëhet si më parë. Historia njerëzore është e mbushur me lëvizje populatash. Çdo gjë rrjedh, thoshte Herakliti duke flouozuar në lashtësi, por megjithëse nuk mund ta pengojmë këtë rrjedhje, nuk është mendim i pranueshëm ai, sipas të cilit, gjatë rrjedhjes, vijnë luftëra dhe shkatërrime. Për shkak të luftërave, gjyshi im u detyrua dy herë të ikte si refugjat, dhe im atë i kaloi vitet e arta të rinisë, rob lufte në një kamp gjatë luftës së dytë botërore. Është një temë për të cilën jam menduar shumë. Pata rastin që ta studioj nga afër, brenda shtëpisë sime. Historia bën cikle, i pëlqejnë edhe lojërat dhe kjo e vërtetë shumë pak na lehtëson, sepse na thotë në sy se ajo që po ndodh sot, ka ndodhur përsëri, dhe do të ndodhë prapë në të ardhmen. Është elementi i Historisë që më pëlqen më pak. Sepse edhe në rastet e fitoreve, gjatë orëve të shndritshme të historisë, disa nëna derdhin lot.

NOFTIM
Studio Përmbartimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e I (Parë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.2/99+3-30, vol 1, faqja 134, ZK 8572, e ndodhur në Lagjen "Loni Dhamo", Lushnjë, e llojit apartamenti, me sipërfaqe 54m2, çmimi 1.920.000(Një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë.
Ankandi zhvillohet në datën 16.11.2018 në ambientet e Studios Përmbartimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA
Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së palauzshme, për të cilën ka venë hipotekë NGB Bank, me këto të dhëna:
• Lloji i pasurisë me sip. 189 m2 nr.pasurie 51189ndm1, zk.8350 vol 28 fq46 RR PMyzogji TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLU
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 256.800 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) EUR
• Lloji i apartamentit sip.15m2 zk.8350 nr.pas.51189ndm1-119 vol 28 fq185 Rruga Prkopaj Myzeqari TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLU
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 105.600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) EUR
Ankandi zhvillohet në datën 03.12.2018, në përfaqim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartimit gjyqësor, me adresë Bulevardi"Bağam Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA
Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së palauzshme për të cilën ka venë hipotekë NGB BANK, me këto të dhëna:
• Lloji i pasurisë Aree Truall me sip. 3000 m2 ,nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475 , Derven, KRUIJE
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) EUR, Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfaqim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartimit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi"Bağam Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Opinion *i* Ditës

Garanci për sigurinë evropiane

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... Këtij diskutimi i dha më shumë "zjarr" Presidenti amerikan, Donald Trump, që e konsideroi "fyes" propozimin në fjalë, më 10 nëntor, pikërisht ditën që nisej për në Paris në festimet zyrtare të 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së I Botërore.

Nuk vonoi reagimi i Kancelares gjermane, Angela Merkel, që e mbështeti këtë propozim në fjalën e saj mbi vizionin e Evropës së re në Parlamentin Evropian, në Strasburg, më 13 nëntor. Madje, ajo ritheksoi se "ka ikur koha kur mund të besonim verbërisht në mbështetjen e të tjerëve dhe nëse duam ta forcojmë komunitetin tonë, duhet të marrim më shumë përgjegjësi për fatet tona". Ndonëse nuk përmendi ndonjë emër, nisur nga zhvillimet më të fundit, ajo la të nënkuptohet SHBA-të, pa përjashtuar edhe ndonjë vend tjetër të mundshëm aleat.

Në fakt, ideja e një ushtrie të përbashkët evropiane nuk është e re, ajo u lançua për herë të parë gati 20 vite më parë mes debatesh dhe polemikash të shumta, pasi shihej si dublim apo dhe karshillëk ndaj NATO-s. Më vonë ajo u spostua nga axhenda politike e BE-së për shkak të ndërhyrjeve ushtarake në Afganistan, Irak, Libi dhe Siri dhe të krizave të rënda financiare, të azilit dhe terrorizmit ndërkombëtar; siç dihet në ato vite u kërka dhe u shfaqën me të drejtë uniteti dhe solidariteti i komunitetit ndërkombëtar, i OKB-së, BE-së, NATO-s dhe të tjerëve, përfshirë edhe vendin tonë.

Ndërkohë, në 2-3 vitet e fundit janë krijuar kushte dhe rrethana cilësish të reja dhe tejet sfiduese për sigurinë ndërkombëtare në përgjithësi dhe atë evropiane në veçanti. Veprimet e njëanshme amerikane në dëm të multilateralizmit, denoncimi i dy traktateve ndërkombëtare në fushën e sigurisë nga armët bërthamore, krisjet në marrëdhëniet transatlantike, rishfaqja e Rusisë, Kinës,



Japonisë etj., me pretendime si fuqi të mëdha po çojnë drejt një arkitekture multipolare shumë më të pasigurt për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, për pasojë krijimi i kësaj ushtrie është bërë jo vetëm "MUST" ose i domosdoshëm, por edhe imperativ.

Në këtë frymë, vitin e kaluar Franca, Gjermania, Britania e Madhe, Spanja, Portugalia, Danimarka, Belgjika, Holanda dhe Estonia lançuan "Nisën e Ndërhyrjes Evropiane (EII). Veç kësaj, 25 vende anëtare nënshkruan Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin e Përhershëm të Strukturuar (PESCO). Këto janë forume tejet të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë evropiane, që merren me përpunimin e doktrinave ushtarake, harmonizimin e veprimeve në raste konfliktesh të armatosura, krizash humanitare, fatkeqësish natyrore etj.

Objektiv tejet i rëndësishëm mbetet përafërimi dhe njësimi i sistemeve të armatimit, me qëllim që nga 180 sisteme në BE, të ketë vetëm 30 të tilla, çka ndikon ndjeshëm në rritjen e shkallës së operacionalitetit luftarak.

Megjithatë, ushtria evropiane është ende larg konturimit të saj dhe do të duhen ende shumë punë dhe përpjekje, që ajo të kthehet në realitet të prekshëm.

Aq më tepër, që veç rezervave dhe kundërshtimeve të mundshme nga vende të tjera, lidhur me këtë ushtri ka dallime jo të vogla dhe ndërmjet Gjermanisë dhe Francës që rrokin fushat politike, legjislativë, ekonomike, diplomatike etj.

Dallimi i parë qëndron në fushën dhe rrezen e veprimit ushtarak. Sipas Presidentit Macron, ushtria e përbashkët evropiane mund të dislokohet edhe në vende

të tjera jashtë BE-së deri në Afrikë. Ndërsa sipas Gjermanisë, kjo ushtri do të veprojë vetëm brenda kufijve të BE-së. Kancelarja Merkel e qartësoi këtë ide edhe në fjalën e lartpërmendur në Strasburg, duke nënvizuar se "me këtë ushtri ne do t'i tregojmë botës se brenda BE-së nuk do të ketë luftë".

Në këtë qëndrim gjeopolitik, Gjermania mban parasysh tre shkaqe/faktorë thelbësorë: së pari, se pa SHBA-të, Britaninë e Madhe apo dhe Turqinë, BE-ja nuk ka këtë ushtri ka dallime jo të vogla dhe ndërmjet Gjermanisë dhe Francës që rrokin fushat politike, legjislativë, ekonomike, diplomatike etj.

Dallimi i parë qëndron në fushën dhe rrezen e veprimit ushtarak. Sipas Presidentit Macron, ushtria e përbashkët evropiane mund të dislokohet edhe në vende

miratimin e Bundestagut, sfidë kjo tejet e vështirë, sidomos tani që shumica parlamentare është fragmentarizuar si asnjëherë më parë dhe kur kancelari po humbet fuqinë e dikurshme.

Mirëpo debatet dhe procedurat përkatëse në Bundestag dhe në vende të tjera do të vononin dhe kompromentonin çdo lloj ndërhyrjeje ushtarake mbrojtëse.

Kësaj objektiv madhor i procedurave të ardhshme do të jetë edhe harmonizimi sa më i mirë i sovranitetit të parlamenteve të vendeve anëtare dhe vendimit nga ana e organeve drejtuese të BE-së.

Në përgjigje të shqetësimit të Presidentit amerikan dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Aleancës së Atlantikut, në fjalën e vet në Strasburg, Kancelarja Merkel pohoi se "ushtria evropiane nuk do t'i kundërvihet dhe as do të paralizojë NATO-n, por vetëm do ta plotësojë atë në raste dhe konflikte të caktuara". Ndërkohë, vendet anëtare do të vijojnë të japin kontributin e tyre, përfshirë edhe realizimin e objektivit prej 2 për qind të GDP-së dhe detyrimet e tjera.

Vetëkuptohet se ushtria e përbashkët do ta bëjë BE-në më të paravarur, më elastike dhe më të aftë në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, në përballimin e krizave dhe konflikteve të ndryshme, duke përfshirë pse jo edhe një refuzim të mundshëm të zbatimit të Nenet 5 të Traktatit të NATO-s, që detyron vendet anëtare të ndërhyjnë dhe të mbrojnë një vend tjetër kur ai sulmohet ushtarakisht. Ndonëse nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë sinjal të hapur, garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë evropiane tani e në të ardhmen do të duhet të ecë sipas parimit "shpresë për më të mirën, por përgatitu për më të keqen".

Së fundi, në vijim të masave dhe reformave të tjera të brendshme dhe të jashtme, krahas garantimit të mbrojtjes dhe sigurisë, ushtria e ardhshme do të ndihmojë BE-në që të kthehet nga një "global payer" në një "global player", ose nga "një donator global", në një "lojtar politik global" në të gjitha fushat.



BLUE TOOTH

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA



te rejat
nga jeta
ipave

çon të shtrua falas me

Dje në "Deutsche Welle"

Viktor Orban më në fund e hapi derën për një refugjat

Nga Boris Georgievski

(vijon nga faqja 1)

... Ai jo vetëm që lejoi një "refugjat" të hyjë në Hungari, por me gjasë paska qenë personalisht i përfshirë në organizimin e të gjithë bagazheve...transportimin në Hungari, kalimin në kufij pa dokumente personale të vlefshme, duke injoruar kështu të gjithë procesin e azilit, aq të kritikuar prej tij për të lejuar një refugjat të sh-trojë kërkesën për azil në Budapest në vend të shtrimit të saj në zonat e transitit në kufi.

Lidhja mes Viktor Orbanit dhe Nikola Gruevskit

Lajmi i keq: Kemi të bëjmë vetëm me një refugjat. E ai nuk po i ikën varfërisë si qindra e mijëra të tjerë që nuk janë lejuar të hyjnë në Hungari në tre vitet e fundit. Emri i tij është Nikola Gruevski, dhe është një i arratisur nga frika e drejtësisë. Ish-kryeministri maqedonas dhe ish-lideri i partisë nacionaliste, VMRO-DPMNE qeverisi Maqedoninë për më shumë se 10 vjet, grumbulloi një pasuri jo të pakët dhe ia doli që ta kthejë të gjithë Perëndimin kundër tij. Por falë stilit të tij autoritar të qeverisjes, ai bëri edhe miq. Viktor Orban dhe Nikola Gruevski ndanin të njëjtin qëllim për t'i kthyer vendet e tyre në "demokraci liberale. Ata që të dy janë kundërshtarë të miliarderit amerikan, George Soros dhe kanë nxitur fushata plot urrejtje kundër organizatave jofit-imprurëse të tij.

Orban është ende duke punuar për planet e tij, por Gruevski, pasi partia e tij humbi pushtetin në viti 2017, ka qenë shumë i zënë me gjetjen e avokatëve për të mbrojtur veten këto vite nga një listë e gjatë akuzash: korrupsion, abuzim me pushtetin, nxitje të dhunës etj.

PAAFËTËSIA E AUTORITETEVE MAQEDONASE

Gruevski e mori dënimin e parë javën e kaluar, pas u gjet fajtor në blerjen ilegale të një mercedesi 570.000 euro. Mendohej se ai do të fillonte të kryente dënimin dy vjeçar këtë javë. Shumë nga ata që vuajtën nën qeverisjen e tij në Shkup, mezi e prisnin futjen në burg të ish-kryeministrit. Por Gruevski kishte plane të tjera. Ndërkohë që policia maqedonase ende kërkonte kryeministrin e zhdukur, ai postoi një mesazh në "Facebook" të martën, duke thënë se është në Budapest duke pritur azil politik nga autoritetet hungareze.

Ka një zhgënjim të madh në Maqedoni pas arratisjes së Gruevskit. Të mërkurën në mbërmje vonë pati madje edhe protesta para qeverisë. Për shumë vetë ai ishte simbol i një regjimi të korruptuar që shkaktoi krizën më të madhe politike në historinë e



vendit. Burgosja e tij mendohej të fillonte një proces të shërimit në shoqëri dhe të rikthente besimin e humbur tek drejtësia dhe sundimi i ligjit. Mund të ketë gjasa që qeveria aktuale të ketë bërë ndonjë "deal" me Gruevskin, siç shprehen disa në Maqedoni, por shkak më i drejtpërdrejtë i arratisjes së Gruevskit është paafëtsia e autoriteteve të Maqedonisë.

ZGJEDHJET E ORBANIT

Viktor Orban nga ana e tij ka

tani përpara zgjedhje të vështira. A do t'i mbetet ai luajal mikut të tij ballkanas dhe do të rrezikojë të hapë një front të ri përplasjeje me BE, në një kohë që marrëdhëniet me unionin nuk janë aspak të mira. Apo do të zgjedhë që ta ekstradojë Gruevskin në Maqedoni dhe të shpëtojë imazhin e tij plot krisje...kjo do të varet nga pozita që do të mbajë Komisioni Europian dhe partitë popullore europiane, ku janë anëtare partitë e Orbanit dhe Gruevskit. Hungaria është

një vend anëtar i BE, Maqedonia një vend kandidat. Për dekada me radhë refreni zyrtar nga Brukseli ishte: të përmirësohej sundimi i ligjit, të luftohej korrupsioni dhe të forcoheshin institucionet demokratike.

Fakti që Viktor Orban tall vendin e tij dhe qeverinë e tij para syve të botës duke i dhënë strehë një të dënuari të kalibr të Gruevskit, është më pak i rëndësishëm. Por fakti që ai hapur tallet me çdo vlerë për të cilën angazhohet Bashkimi Europian duhet të jetë një arsye për shqetësim në Bruksel dhe vendet anëtare të BE. Lëvizja e fundit e Orbanit na dëshmon, se ai jo vetëm që e ndjek me sukses modelin autoritar të bazuar në korrupsion, degradimin e institucioneve demokratike dhe duke e bërë të heshtë median në vend, por ai me efektivitet e eksporton këtë model në vendet fqinje që ndjekin shembullin e tij. E kaq duhet të mjaftojë për ta ngritur në këmbë BE.

HOROSKOPI

DASHI

Duhet të tregoni më tepër durim, sepse mund të shpërbleheni me të mira materiale. Kjo është vërtetë një ditë e mirë, që ka si qëllim rezultate tepër domethënëse dhe të suksesshme për ju.

DEMI

Është momenti i përshtatshëm për të përgatitur veten tuaj për momente romantike. Nëse jeni duke njohur dikë, gjërat midis jush do të marrin një drejtim pozitiv dhe më serioz.

BINJAKET

Duhet të siguroheni me veten tuaj që po bëni të pamundurën për t'u përqendruar në karrierën tuaj, megjithëse gjërat janë të vështira. Ndoshta disa probleme në dashuri ju kanë shpërqendruar.

GAFORJA

Sot mund të merrni disa komplimente, të cilat do t'u ngrenë moralin dhe vetëbesimin. Shfrytëzojeni energjinë pozitive për të arritur disa rezultate pozitive në karrierën tuaj. Jeta romantike duket mjaft mirë.

LUANI

Mundohuni që ta zhvishni veten nga egoizmi. Shenja juaj e ka me tapri këtë ditë shpesh mund t'ju fusë në keqkuptime. Në dashuri pritjet të merrni lajme të mira nga një person, i cili ju vëzhgon prej kohësh.

VIRGJERESHA

Jeni duke kaluar nëpër disa faza nervozizmi si pasojë e mosmarrëveshjeve në punë. Përpuni që t'i vendosni pikat mbi i disa në disa tema delikate. Sa i përket dashurisë, gjithçka shkon si duhet.

PESHORJA

Jini të durueshëm, pavarësisht nga disa lëvizje irrituese nga ana e disa kolegëve që janë aty për të sulmuar gjithkënd. Por pavarësisht këtyre situatave jo të këndshme, ju do të arrini t'i luftoni këto kontradikta.

AKREPI

Shmangni thashethemet me kolegët për të mbajtur një reputacion të mirë. Ata që i përkasin shenjës suaj, do të marrin lajme të mira në punë. Në dashuri keni nevojë për një impuls të ri.

SHIGJETARI

Do të merrni disa lajme të mira sa i përket karrierës. Nuk do të mungojë sensi i përgjegjësishë e kjo do të lejojë t'u shkonte në fund planeve tuaja. I vetmi aspekt negativ mund të përfshijë fushën e dashurisë.

BRICJAPI

Personat që nuk janë në një lidhje së shpejti do të krijojnë kontakte të reja, të cilat mund të krijojnë marrëdhënie afatgjatë. Një biznes tek i cili keni pasur shumë shpresë nuk do të funksionojë si duhet.

UJORI

Nëse po planifikoni ndonjë udhëtim të largët, përpuni që ta shmangni për momentin. Fokusohuni te problemet imediatë në punë, cilat i keni lënë pezull dhe që kanë nevojë për zgjidhje.

PESHQIT

Dëgjojeni intuiën tuaj dhe përkushtojuni ëndrrave tuaja. Çfarë do që të bëni në jetën tuaj publike, do të ketë efekt pozitiv. Sot mund të takoni një mik të vjetër, me të cilin do të kaloni çaste emocionuese.

PORTIERI I MILANIT

Luan te Milani dhe me kombetaren italiane, është vënë përballë emrave më të njohur të futbollit botëror. Por ndeshja përballë Kristiano Ronaldos ka qenë shumë e veçantë për Xhixhio Donarumën, i cili ka pranuar se ka qenë shumë i emocionuar kur u vu përballë yllit portugez që iu


bashkua Juventusit në verë. "Takimi me CR7? Ish-te një emocion i madh, kam luajtur gjithmonë në Play Station kundër tij. Nuk i thamë asgjë njëritjetrit pasi kisha turp", deklaroi sot portieri italian për "Rai Sport", duke folur për ndeshjen e fundjavës ku portugezi në jetën reale e mundi me bardhezinjtë dhe arriti edhe t'i shënonte

Donaruma: Ronaldos nuk i fola, sepse kisha turp

te gol. Atë ndeshje Milani e mbylli me 10 lojtarë, pas kartonit të kuq të Higuain, i cili u ndëshkua pas një proteste shumë të tepruar ndaj gjyqtarit dhe nuk u kursye me ulërime edhe ndaj Kristiano Ronaldos. Ajo i kushtoi kartonin e

kuq dhe një pezullim dyjavor argjentinasit, një gjest aspak i këndshëm për të cilin Donaruma tregon se sulmuesi kërkoi falje pas ndeshjes. "E kemi falur edhe ne, ai është një djalë i mbarë, na kërkoi falje dhe para shtypit. Janë

gjëra që ndodhin, për të ishte një ndeshje shumë e rëndësishme. E rëndësishme është të kuptosh që ke bërë një gabim dhe të mos e përsëritësh. Pastaj foli edhe me gjyqtarin e i kërkoi falje edhe atij, Gatzou nuk i tha asgjë, e la të shfrynte, përndryshe...", tha duke qeshur Donaruma.



Stadiumi i ri i Kukësit do të nisë në vitin 2019

Federata Shqiptare e Futbollit ka vendosur të dhurojë 2.5 milionë euro për ndërtimin e ri të stadiumit të Kukësit. Ky impiant do të ndërtohet në bashkëpunim me qeverinë shqiptare. Mbledhja e komitetit të FSHF-së ka marrë vendimin për të akorduar këtë shumë. Gjithë investimi pritet të shkojë në 5 milionë euro. Ky investim është ende në fazë projektimi. Stadiumi mendohet se do të ketë 6500 vende dhe do t'i përkasë kategorisë "Elite 3". Kjo kategori parashikon që të zhvillohen ndeshje deri në fazat e grupeve të Kupave të Europës. Fillimi i punimeve pritet të nis vitin e ardhshëm dhe kohëzgjatja të marrë 9 muaj. Kukësi është detyruar të luajë takimet jashtë qytetit pasi "Zeqir Ymeri" është mbyllur. Pritet që vetëm në sezonin e ardhshëm, 2019-2020 Kukësi të arrijë të luajë në impiantin e ri. Stadiumi do t'i kalojë bashkisë së qytetit për menaxhim, ndërkohë që në kontratë parashikohet që në këtë stadium mund të zhvillojnë ndeshjet e tyre ekipet kombëtare.

E pabesueshme, në Lozanë pranojnë "mungesën e informimit të brendshëm" dhe kërkojnë ndjesë



Jeton Selimi

KAS-i konfirmon gafën e tij: Skënderbeu ka apeluar!

E-maili: Shpresojmë mos të kemi sjellë shqetësime

Kaos dhe pakënaqësi si pasojë e një gafe, e mungesës së komunikimit të brendshëm në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv. I gjithë konfuzioni i krijuar një ditë më parë mbi çështjen "Skënderbeu" dhe mungesën e një apelimi nga klubi korçar është hedhur sërish poshtë nga vetë gjykata me e lartë e drejtësisë sportive, e cila pas insistimit të News24, saktësoi se ekziston një çështje Skënderbeu e apeluar në KAS. Në fakt, ishte e çuditshme që klubi korçar të mos e kishte apeluar një dënim të tillë, e cila do të ishte fundi për Skënderbeun. Pasi kontaktuam me presidentin e klubit Ardian Takaj, një ditë më parë, News24 i dërgoi një tjetër email sekretariatit të KAS ku kërkuam një tjetër përgjigje në një kohë kur i bëmë më dije edhe pretendimin e presidentit Takaj. Përgjigja e dytë e KAS ishte po aq befafuesë, pasi një gabim i tyre, një mungesë komunikimi, prodhoi një lajm



që bëri shumë zhurmë: "Sa i përket kësaj çështje, si pasojë e mungesës së komunikimit

të brendshëm ju u informuam se nuk kishte asnjë çështje të regjistruar mbi këtë temë,



ndërkohë që përgjigja korrekte ishte se nuk është regjistruar asnjë date mbi

seancën. Pasi kontrolluam të dhënat në të vërtetë është e qartë se ekziston një apelim në pritje në CAS mes KF Skënderbeu dhe UEFA në lidhje me vendimin e lëshuar nga trupa e apelimit të UEFA me 26 prill. Ju kërkoj ndjesë për gabimin në mesazhin e pare dhe kuptoj konfuzionin që mund të ketë shkaktuar. Procedura e arbitrazhit të CAS është në vazhdim dhe paneli i arbitrarëve është emëruar, lexohet në përgjigjen e KAS, sigurisht lajmi i dytë shfuqizon të parin, lajmi i mirë është që Skënderbeu vijon të besojë në pafajësi, ndërsa për KAS ky pa diskutim ky është një "autogol" i pahijshëm për një nivel të tillë që është kjo gjykatë në Lozanë.

Të kuqtë me mungesa në stërvitje

Partizani nis përgatitjet pa lojtarët e përfaqësuesve

Partizani nis përgatitjet për ndeshjen e radhës që do të zhvillojë në Vlorë. Trajneri Skënder Gega dhe skuadra janë të përqendruar te sfida e radhës me kuqezinjtë, ku synohen 3 pikët. Në seancën e sotme stërvitore kanë rënë në sy disa mungesa, ku bien në sy portieri Livjo Malaj, por edhe Rubin Hebah, Esat Mala, apo edhe Besnik Ferati, të cilët janë të grumbulluar dhe impenjuar me skuadrat përfaqësuese respektive. Ndërkohë, portieri Alban Hoxha i është nënshtruar një terapie intensive, pasi po bën të pamundurën që të jetë në fundjavën e ardhshme në transfer të vlonjate, një nga duelet më delikate të të kuqve, të cilët synojnë që të mos e lëshojnë më vendin e parë në Superiore. Partizani, aktualisht ka 31 pikë dhe mban vendin e parë, ndërsa Skënderbeu i dyti me 29



Por edhe Suso e Neymar në listën e dëshirave

Merkato yjore për Realin, në majë është Hazard


Reali i Madridit nuk po kalon një moment aspak të mirë dhe kriza të madrilenët solli edhe shkarkimin e trajnerit Lopetegui. Por ky ishte vetëm hapi i parë për ndryshim te Reali, pasi në merkato pritet një investim i majmë nga presidenti Perez. Ja kush janë dëshirat e "Los Blancos" për muajin janar.
EZEKIEL PALASIOS
Ezequiel Palacios është një marrëveshje e kryer. Sipas "Marca", argjentinasit do të nënshkruajë për Real Madridin sapo "Copa Libertadores" të marrë fund. Ai do t'i kushtojë klubit rreth 20 milionë euro dhe Palacios do të nënshkruajë një marrëveshje që zgjat deri në 2024.

ALEKSIS SANÇEZ
Aleksis Sanchez është një nga më të mirët në Premier Ligë. Ai ishte një lojtar kyç të Barcelona dhe Arsenalit, por te Junajtidi ka dështuar. Killiani ka shënuar vetëm katër gola në 29 paraqitje për "Djajtë e Kuq". Sipas "OK DIARIO", agjenti i 29-vjeçarit i ka ofruar klientit të tij Real Madridit. Klubi spanjoll po kërkon të përforcojë sulmin dhe Sanchez mund të jetë opsioni i përsosur.
SUSO
Suso është një nga më të mirët në Evropë për momentin. Spanjollit ka shënuar katër gola dhe ka

asistuar tetë të tjerë në vetëm 12 paraqitje në Serie A. Ai është padyshim lojtari më i mirë i Milanit, të cilët janë duke u përpjekur të mirë për ta mbajtur me të gjitha mënyrat në Milano. 24-vjeçari ka një klauzolë prej 38 milionë eurosh. Ish-futbollisti i Liverpoolit është i interesuar të qëndrojë në Itali, jo i interesuar për klubet që ndjekin nënshkrimin e tij.
NEJMAR
Ish-lojtari i Barcelonës thuhet se dëshiron të largohet nga klubi francez, PSG. 26-vjeçari dëshiron të jetë ylli i klubit, prandaj ai u largua nga Spanja, ku ishte

nën hijen e Mesit. Në Francë, ai është eklipsuar nga Kilian Mbape, i cili fitoi Kupën e Botës gjatë verës dhe Reali i Madridit shihet si mundësia më e mirë për të.
EDEN HAZARD
Eden Hazard aktualisht vlerësohet në treg 150 milionë euro, lojtari më i vlefshëm në Premier Ligë. 27-vjeçari gjithmonë ka shprehur dashurinë e tij për Madridin, madje duke lënë të kuptohet se ka pasur kontakte me presidentin Perez. Në janar, ylli i Belgjikës mund të bashkohet me shokun e tij, Tibo Kurtua.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ferguson trainer.
- Grand Prix
- Eshtë stacion beduinësh.
- Një artikull jo për vejetarian
- Kujt i vjen... di të bëjë.
- Kaçaturian kompozitor
- Logot pa kujfij
- Parashtesë për vetë.
- Aktorja protagoniste e Vertigo.
- Ndezur në aparaturë.
- Eshtë si telefilm.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Eshtë me shumë se kërkuesë.
- Cristiano bomber te Real Madrid.
- Teket e grave.
- Në krye të masave.
- Shkon goja... nga nepsi.
- Duken të gjata ato të pritjes.
- Gjysmë batakut.

- Eshtë për medaljen e parë
- Eshtë kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
- Një "bombë" tenisistike.
- Fillojnë mykjen
- Janë këngëtarët si Jose Carreras
- Eshtë këngë e kënduar nga komiku
- Lumë në Francë.
- Piktori i Ura e Narnit.
- Kapen në kujfij

VERTIKAL

- Në hyrje të ambientit
- Neeson aktor.
- Ente Sociale Rumune.
- Ajo e zezë nënkpion arbitrin.
- Kufizojnë stacionin.
- Tremb fëmijët.
- Jepet për t'u marrë.
- Kyjet japonez.
- Eshtë pemë
- Janë tallësit.
- Roberto trainer italian.
- Freni këngëtare lirike.
- Gjysmë totale.
- Një si divan.
- Tipare pa zë
- Ulet në dhomën e lartë.
- Moore aktor.
- Qe bomber brazilian.
- Ishte shpërthimi i Little Boy.
- Carolina, e bukura e Belle epoqe.
- Mbarojnë fare
- Pullman aktor.
- Eshtë thëllimi
- Meg aktore.
- Ndërmarrje Industriale Rajonale.
- Një lidhëz.
- Kaluar në krye.
- Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Mund të hidhet te kiromanti
- Teket e kafes.
- D'stria e Helena Gjikhës
- Smith filozof.
- Kukë regjisor
- Një pjesë e minoritetit.
- Moduli i Neil Armstrong.
- Mund të jenë qitjeje.
- Markë pistolete.
- Mbylli fushatat.
- Eshtë dorëzim.
- Eshtë detar.
- Fillojë ilustrimet.
- Eshtë hon.
- Diftong në duel
- Një pjesë e rifillimit.
- Një që kuron karien.
- Nganjëherë duhen vënë mbi.
- E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


- Janë thënie e famshme.
- Janë trupa qellore të tillë.
- Inicialet e Stone regjisor
- Memoria në computer
- Në krye të trupave.
- Mund të jenë diskografike.
- Eshtë e zakonshme për pushime
- Skudër greke.
- Bel i Maupassant.
- Eshtë thesar.
- E famshme ajo maqedonase.
- Një zakon.
- Bëjnë alarm me ar
- Inicialet e Mallë regjisor
- Mund të jetë telefonike
- Ka dy faqe
- Mund të jetë një cutter.
- Në mes të dhomës.
- Mbahet me bateri.
- Përfshijnë edhe Haitin.
- Denis i enëve me presion.
- Paguhen për shërbime.
- Janë ufo.
- Ekstremit në tunel.
- Një atentator vetëvrasës.
- Markë cigaresh.
- Arrihet duke mundur.
- Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
- Eshtë aparati me zorrë.
- Pak servilizëm.
- Kështu e ka syrin vigjilenti.
- Fatih trainer turk.
- ... Nostra me mafiozët.
- Mbyllin punimet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Kufizojnë në teknik.
- Fillojnë panikun.
- Fund tuneli.
- Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1				3	6				
9			6	5					2
			8	9		3	1		
	2	4		1	5				
	6		3		7	8	4		
				6					
		5							6
6	3		7	9		5	4		
9	1						3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	3	7	8	4	1	9	5	2	
9	8	4	2	5	6	1	3	7	
5	1	2	3	7	9	6	4	8	
1	4	3	5	8	2	7	6	9	
7	6	8	4	9	3	2	1	5	
2	9	5	1	6	7	3	8	4	
3	5	9	6	2	8	4	7	1	
4	2	1	7	3	5	8	9	6	
8	7	6	9	1	4	5	2	3	

Argëtim filozofik

- Mund të zbulosh më shumë për atë person në një orë lojë se në një vit bisedash.
- Është e vështirë që të ndodhë diçka pa një arsye apo pa një parim.
- Fillimisht ki një objektiv të qartë. Së dyti, gjej mjetet për ta arritur. Së treti përshtat mjetet.
- Njerëzit i krijojnë zotat sipas vetes, jo vetëm për nga pamja, por edhe për nga mënyra e jetesës.
- Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës nuk është aspak edukim.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11		5	9	6	11	1	4	3
12	16	15	17	6	11		15		4		12	2
6		1	4	12	6	11		5	18	11	2	9
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3	
2		1	7	3	2	9	7	9	2	3		
14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3		
18	4		6	9	8		4	12		7	9	
9	2	12	2	4		12	3		9	2	18	
4	8		2	3	8	6	6		6	16	15	
5	4	12	3		11	2	5		3	6	12	
15	3	6		1	2	3	4		5	2	11	2
17		9	9	15	16	4		4	9	3	2	3

R	A	S	T	E	T	P	A	P				
U	R	A	T	U	R	H	P	A				
S	A	M	M	A	R	A	I	S				
I	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E		
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	U		
B	E	T	O	N	E	K	B	O	R			
S	A	L	I	R	A	M	A					
T	O	N	T	I	T	U	L	L	I			
A	R	E	S	A	O							
P	J	A	R	Z	O	T	I	M	I			
A	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S		

- Politika nuk ka lidhje me moralin.
- Një princi nuk i mungojnë kurrë arsyt legjitim për të thyer premtimin e tij.
- Një sundimtar i mençur nuk duhet ta mbajë besën kurrë nëse duke bërë kështu do të jetë kundër interesave të tij.

Thënie të mençura

- Miku i të gjithëve nuk është miku i askujt.
- Ka vetëm një mënyrë për të shmangur kritikizmin: mos bëj asgjë, mos thuaj asgjë dhe jti thjesht asgjë.
- Gabimi vjen në shumë mënyra, ndërsa për të bërë gjërat siç duhet ka vetëm një rrugë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

N	E	N	T	O	K	A	A	S	C	E		
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	E	S	
O	R	K	E	L	P	A	N	T	E	R	A	T
B	A	K	E	L	K	A	N	D	I	L	E	T
B	A	K	U	N	I	N	A	D	A	M		
T	A	M	A	R	O	C	O	O	A	K		
M	E	E	O	N	A	T	A	N	D	U		
A	T	T	O	N	I	K	P	I	E	R		
R	I	T	L	I	Z	E	O	T	T	O		
K	E	V	A	D	E	T	I	E	I	R		
E	L	S	A	P	A	L	N	O	A			
T	A	T	P	I	R	A	T	E	R	I	A	
T	I	R	A	N	A	H	R	P				
O	R	A	R	I	B	T	E	A	T	E	R	
R	O	M	A	K	A	B	I	R	B	E	D	I
T	N	A	B	A	R	I	T	O	N	I	L	
U	T	R	A	M	B	O	T	I	E	R		
R	A	D	I	P	A	G	A	N	I	Z	M	I
R	A	D	I	F	E	R	R	A	L	A	I	
T	P	A	R	T	I	A	K	I	N	A	T	
L	A	L	A	F	E	M	R	A	H			
P	E	L	I	K	A	N	I	I	T	H	E	
M	I	J	A	S	O	N	I	E				
A	P	A	R	A	T	E	P	A	R			

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

